




safejournalists.net

SHQIPËRIA

Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në Shqipëri 2020



SHQIPËRIA
Treguesit e nivelit
të lirisë së mediave
dhe sigurisë së
gazetarëve në
Shqipëri 2020

Autor
Blerjana Bino

Titulli origjinal

Shqipëria – Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në Shqipëri 2020

Botues

Independent Journalists' Association of Serbia
Tirana, 2021

Autor

Blerjana Bino

Redaktorë

Aleksandër Çipa
Besar Likmeta
Blerina Fani

Përkthimi

Durim Tabaku

Tirazhi

50 kopje

Arti grafik

comma | communications design

Ky botim u bë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e autores dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Tabela e përmbajtjes

PËRMBLEDHJE DHE QËLLIMI I PROJEKTIT	4	B Pozicioni i gazetarëve në redaksitë e lajmeve	20
DY FJALË PËR METODOLOGJINË	5	B1 Kufizimet ekonomike për lirinë e gazetarëve	20
Hyrje	7	B2 Pavarësia editoriale në mediat private	21
A Mbrojtja Ligjore	9	B3 Pavarësia editoriale e transmetuesit të shërbimit publik	22
A1 Garancitë ligjore për lirinë e mediave dhe të gazetarëve dhe zbatimi i tyre në praktikë	9	B4 Pavarësia editoriale në mediat jofitimprurëse	23
A2 Efektet e Ligjit të Shpifjes të gazetarët	13	B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	24
A3 Mbrojtja ligjore e pluralizmit politik në media	15	B6 Pozicioni ekonomik i grave gazetare	25
A4 Liria e punës dhe shoqatës së gazetarëve – garancitë ligjore dhe praktika	16	C Siguria e gazetarëve	26
A5 Mbrojtja ligjore e burimeve të gazetarëve	17	C1 Statistikat për sigurinë dhe pandëshkueshmërinë	26
A6 Mbrojtja e së drejtës për akses tek informacioni	18	C2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe aktorëve politikë në lidhje me mbrojtjen e gazetarëve	29
		C3 Sjellja e sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve	30
		Përfundime dhe Rekomandime	32

PËRMBLEDHJE DHE QËLLIMI I PROJEKTIT

Ky është viti i pestë radhazi që shoqatat e gazetarëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor (Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi, Kosova dhe Serbia), me mbështetjen e Komisionit Evropian¹, monitoruan zhvillimin e lirisë së medias dhe sigurinë e gazetarëve në vendet e tyre. Në vitin 2020 në këto vlerësime u përfshinë edhe dy vende të tjera – Shqipëria dhe Kroacia. Metodologjia e hulumtimit e zhvilluar në 2016² u përpunua edhe më tej gjatë këtyre viteve për të standardizuar mbledhjen dhe analizimin e të dhënave dhe për të përshtatur fokusin e kërkimit drejt zhvillimeve në mjedisin e mediave tradicionale dhe atyre online në vendet e Ballkanit Perëndimor. Bazuar në këtë instrument të standardizuar hulumtim, shoqatat e gazetarëve vlerësuan zhvillimet më të reja në vendet e tyre dhe u angazhuan në aktivitete të ndryshme advokimi për të përmirësuar mjedisin politik, legjislativ dhe institucional në të cilin punojnë gazetarët dhe media.

-
- 1 Në dhjetor 2019, Komisioni Evropian miratoi projektin tre-vjeçar [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net), i cili synon fuqizimin e shoqatave kombëtare të gazetarëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor për t'u bërë aktorë të pavarur efektivë dhe të përgjegjshëm për mbrojtjen dhe zbatimin e standardeve të BE-së në fushën e lirisë të mediave, me qëllim afatgjatë të përmirësimit të të drejtave të qytetarëve për të bërë zgjedhje të bazuar në informacione. Ky veprim përfaqëson kalimin në një tjetër nivel të projektit të mëparshëm (Platforma Rajonale e Ballkanit Perëndimor për Mbrojtjen e Lirisë së Medias dhe Sigurisë e Gazetarëve), bazuar në njohuritë dhe përvojën e akumuluar në periudhën 2016-2018. Programi i Ndihmës për Shoqërinë Civile dhe Mediat 2018-2019 ofron mbështetje për rrjetet tematike rajonale të organizatave të shoqërisë civile, mbështetje për një rrjet rajonal për të drejtat e grave dhe barazimin gjinorë dhe mbështetje për projekte të vogla që promovojnë bashkëpunimin mes komuniteteve dhe qytetarëve nga Serbia dhe Kosova.
 - 2 Edicioni i pestë i përshtatur i metodologjisë hulumtuese për këtë projekt hulumtimi për advokim u zhvillua nga Snezana Trpevska dhe Igor Micevski, bashkëpunëtorë shkencorë të Institutit Kërkimor për Zhvillimin Social RESIS nga Maqedonia e Veriut (www.resis.mk).

DY FJALË PËR METODOLOGJINË

Metodologjia e hulumtimit përbëhet nga tre grupe treguesish të zhvilluar në bazë të një analizë të plotë të udhëzimeve të ndryshme të hartuara nga organizatat përkatëse ndërkombëtare.³ Gjatë viteve të kaluara, treguesit e mëparshëm u testuan dhe u përpunuan për të trajtuar kontekstin e veçantë social-politik të këtij rajoni dhe për të pasqyruar nevojat specifike dhe interesat e gazetarëve në të shtatë vendet e rajonit.

U zbatuan një sërë metodash të ndryshme kërkimore për të mbledhur dhe analizuar të dhënat me qëllim që t'i japim përgjigje pyetjeve që lidhen me secilin tregues specifik:

- Shqyrtimi i studimeve, analizave, raporteve kërkimore, dokumenteve politike, strategjive dhe dokumenteve të tjera;
- Analizës cilësore e dokumenteve ligjore;
- Marrja dhe analizimi i informacionit të botuar në faqet zyrtare të institucioneve publike dhe organizatave dhe ente të tjera;
- Marrja dhe analizimi i deklaratave për shtyp, njoftimeve dhe informacioneve të tjera të prodhuara nga organizatat profesioniste;
- Të dhënat dytësore të mbledhura nga shoqatat e gazetarëve;
- Intervista të thelluara me ekspertë, gazetarë, politikëbërës, etj.;
- Diskutime në fokus grupe me gazetarë; dhe
- Sondazh me gazetarët (në disa vende).

Në Shqipëri, mbledhja e të dhënave dhe hartimi i raportit narrativ u bënë nga një studiues kombëtar, raport që më pas u rishikua nga ekspertët kombëtarë të emëruar dhe nga hulumtuesi kryesor. Në këtë vend të Ballkanit Perëndimor, Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt angazhoi Blerjana Binon si studiuese kombëtare për të hartuar raportin. Ky i fundit u redaktua nga ekspertja ligjore Blerina Fani dhe ekspertët e medias Aleksandër Çipa dhe Besar Likmeta sipas fushave të tyre.

Në tabelën e mëposhtme jepen tre grupet e treguesve që janë përdorur për vlerësimin e nivelit të lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve në Ballkanin Perëndimor.

Tabela 1: Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve

A. Mbrojtja ligjore	B. Pozicioni i gazetarëve në redaksitë e lajmeve	C. Siguria e gazetarëve
A.1 Garancitë ligjore për lirinë e mediave dhe gazetarëve dhe zbatimin e tyre në praktikë	B.1 Kufizimet ekonomike për lirinë e gazetarëve	C.1 Statistikat për sigurinë dhe pandëshkueshmërinë
A.2 Efektet e Ligjit të Shpifjes të gazetarët	B.2 Pavarësia editoriale në mediat private	C.2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe aktorëve politikë në lidhje me mbrojtjen e gazetarëve
A.3 Mbrojtja ligjore e pluralizmit politik në media	B.3 Pavarësia editoriale e transmetuesve të shërbimit publik	C.3 Sjellja e sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve
A.4 Liria e punës dhe shoqatës së gazetarëve – garancitë ligjore dhe praktika	B.4 Pavarësia editoriale në mediat jo-fitimprurëse	
A.5 Mbrojtja ligjore e burimeve të gazetarëve	B.5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	
A.6 Mbrojtja e së drejtës për akses tek informacioni	B.6 Pozicioni ekonomik i grave gazetare	

³ Gjatë hartimit të gjasjes specifike kërkimore për vendet e Ballkanit Perëndimor u morën në konsideratë këto dokumente: Këshilli i Evropës: Treguesit për Mediat në një Demokraci; UNESCO: Treguesit e Zhvillimit të Mediave (MDI) dhe Treguesit e Sigurisë së Gazetarëve: Niveli kombëtar; USAID – IREX: Indeksi i Qëndrueshmërisë së Mediave; Freedom House: Sondazhi për Lirinë e Shtypit; Trusti i Shërbimit Botëror të BBC: Nisma për Zhvillimin e Mediave Afrikane; Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve: Dhuna ndaj Gazetarëve; Reporterët pa Kufij: Indeksi Botëror i Lirisë së Shtypit.

Shqipëria ka bërë përparim të madh drejt demokratizimit në tridhjetë vitet e fundit pas rënies së regjimit komunist. Që nga viti 2014 është vend kandidat i Bashkimit Evropian (BE) dhe në mars 2020 BE hapi negociatat e anëtarësimit me vendin tonë⁴. Shqipëria është republikë parlamentare me parlament me një dhomë dhe ka një kushtetutë që u miratua në 1998 me ndryshime në 2008 dhe 2020. Ka sistem zgjedhor proporcional rajonal. Ajo është anëtare e NATO-s që nga viti 2009 dhe e konsideron aleancat e saj Euro-Atlantike të një interesi strategjik kombëtar me rol përgjithësisht konstruktiv në Ballkanin Perëndimor.⁵ Pakicat kombëtare në Shqipëri janë ato greke, maqedonase, vllah/arumune, rome, egjiptiane, malazeze, bullgare, boshnjake dhe serbe.⁶

Situata politike në Shqipëri karakterizohet nga konfliktet dhe tensionet e vazhdueshme, të cilat shpesh kanë minuar reformat e nevojshme institucionale dhe ekonomike të vendit. Polarizimi politik dhe kultura e dobët e dialogut politik kanë penguar përpjekjet

-
- 4 Këto korniza përcaktojnë udhëzimet dhe parimet që rregullojnë negociatat e anëtarësimit për secilin vend kandidat. Për më shumë informacion, vizitoni https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/albania_en. Konferencat e para ndërqeveritare duhet të mbahen sa më shpejt të jetë e mundur pas miratimit të kornizave negociuese nga Këshilli. Para konferencës së saj të parë ndërqeveritare, Shqipërisë i është kërkuar të bëjë përparim të mëtijshëm me reformat zgjedhore dhe gjyqësore dhe me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Edhe trajtimi i fenomenit të azilkërkuësve pa shkak dhe ndryshimi i ligjit për media mbeten përparësi të rëndësishme. Komisioni do të raportojë për këto çështje kur të paraqesë kornizën negociuese për Shqipërinë. Për më shumë hollësi vizitoni https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/pt/ip_20_519.
- 5 Komisioni Evropian. Raporti për Shqipërinë 2020, f. 8, aksesuar më 20.01.2021, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf
- 6 Ligji Nr. 96/2017, "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë", aksesuar më 20.01.2021, <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1524738824-Ligji-Per-Mbrojtjen-e-Pakicave-Kombetare-ne-R.Sh-2017.pdf>

për reforma të qeverive të njëpasnjëshme.⁷ Aktualisht, në pushtet është Partia Socialiste e Shqipërisë si në nivelin qendror ashtu edhe në atë vendor dhe pritet të vazhdojë të qeverisë vendin pas fitores në zgjedhjet parlamentare të 25 prillit. Shqipëria ka një rekord zgjedhjesh garuese, pavarësisht se partitë politike janë shumë të polarizuara dhe shpesh të organizuara rreth personaliteteve kryesore që i drejtojnë ato.⁸ Largimi nga parlamenti dhe bojkotet e zgjatura nga opozita janë të shpeshta dhe logjika e politikës së kundërshtarit shpesh e detyron opozitën të kundërshtojë propozime legjislativë që, nëse do të ishte vetë në pushtet, do t'i kishte mbështetur ato.⁹ Institucioneve publike u mungon kultura e të qenurit të hapur, gjë që vihet re në sjelljen e tyre hermetike dhe të papërgjegjshme, në angazhimin selektiv dhe në tendencën për të mos dhënë apo për të kufizuar informacione. Kjo asimetri strukturore çon në një qëndrim prej padroni dhe mospërfillës ndaj OShC-ve dhe mediave të pavarura nga ana e zyrtarëve dhe institucioneve publike. Kultura e dobët demokratike që e sheh partinë politike si burim pushteti dhe privilegji ka rritur pritshmëritë e drejtpërdrejta dhe të atypëratyshme të qytetarëve ndaj partive, duke u dhënë këtyre të fundit monopolin mbi vendimmarrjen pa pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve, duke pasur parasysh edhe efikasitetin e kufizuar të mekanizmave aktualë.¹⁰

Shqipëria është ekonomi në tranzicion dhe, sipas Bankës Botërore (2019), u rrit nga një prej shteteve më të varfra në Evropë në një vend me të ardhura të nivelit mesatar. Sfidë për Shqipërinë është të ecë drejt një modeli ekonomik që përqendrohet tek investimet dhe që siguron rritje të orientuar nga eksporti, duke ndihmuar ata me më pak akses dhe mundësi. Bujqësia dhe turizmi kanë qenë dy nga sektorët me performancën më të mirë në vitet e fundit, ndonëse kriza COVID-19 ka sjellë pengesa serioze për rritjen ekonomike. Pabarazia mbetet një problem tepër i madh duke pasur parasysh se 40% e popullsisë jeton në varfëri.¹¹ COVID-19 vuri në vështirësi funksionimin e medias, veçanërisht për sa i përket burimeve financiare, ku pati rënie të reklamave, falimentime të mediave, shkurtime të pagave, pushime nga puna të stafit të mediave, por që solli vështirësi edhe në drejtim të lirisë dhe sigurisë, siç janë rreziku

ndaj shëndetit dhe sigurisë së gazetarëve dhe stafit të mediave gjatë raportimit nga terreni.

Mediat në Shqipëri kanë bërë transformime të mëdha duke iu përgjigjur ndryshimeve social-kulturale, politike dhe ekonomike të vendit dhe përparimeve në teknologji, tendencave globale të medias dhe, së fundmi, edhe krizës COVID-19. Zhvillimi i mediave në Shqipëri në tre dekadat e fundit nuk ka qenë linear. Përkundrazi, ai reflekton një peizazh dinamik, të pasur dhe të larmishëm mediatik me tiparin kryesor të dominimit të mediave klienteliste, të karakterizuar nga ndërvarësi dhe lidhje të fshehta mes medias, politikës dhe biznesit. Shqipëria ka një sistem transmetimi të dyanshëm, me Radio Televizionin Shqiptar (RTSH) si transmetues publik në shërbim të publikut dhe media të lulëzuar private me 7 kanale televizive kombëtare, 3 radio kombëtare, 48 kanale televizive vendore, 56 radio vendore, 2 platforma tokësore/satelitore me pagesë dhe me më shumë se 650 media online. Unioni i Gazetarëve Shqiptarë ka rreth 1,200 anëtarë, ndërsa numri i përgjithshëm i gazetarëve në 2018 ishte afërsisht 1,750.

7 Peter Tabak dhe Sanja Barkovic, „Diagnoza e Shqipërisë 2019”, Londër: Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, 2020.

8 Gjergji Vurmo. “Liria në botë 2020: Shqipëria”, aksesuar më 15.05.2021, <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2020>

9 Peter Tabak dhe Sanja Barkovic, “Diagnoza e Shqipërisë 2019”, Londër: Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, 2020, f. 8.

10 Afrim Krasniqi and Adrian Hackaj. “Albanians and the European Social Model: Internal Democracy in Albanian Political Parties”, f. 16, aksesuar më 20.01.2021, <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/11317.pdf>

11 Institute of Statistics, Albania in figures in 2020. Aksesuar më 14.03.2021: <http://www.instat.gov.al/publikime/librat/2020/shqip%C3%ABria-n%C3%AB-shifra-2019/>

A1 Garancitë ligjore për lirinë e mediave dhe të gazetarëve dhe zbatimi i tyre në praktikë

A garantohet e drejta për lirinë e shprehjes dhe informimit? A përfshin kjo e drejtë edhe aksesin në internet? A zbatohen në praktikë garancitë ligjore?

Kushtetuta e Shqipërisë garanton lirinë e shprehjes, lirinë e medias dhe lirinë e informimit¹². Ajo parashikon që e drejta e lirisë së shprehjes, të medias dhe informimit mund të kufizohet me ligj “për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve”.¹³ Legjislati në fuqi për lirinë e shprehjes nuk përfshin drejtpërdrejt aksesin në internet. Megjithatë, në Shqipëri, aksesin në internet është i garantuar përmes Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Kuadri ligjor për të drejtën e lirisë së shprehjes dhe informimit nuk zbatohet plotësisht në praktikë me shenja të përkeqësimit të lirisë së shprehjes, të informimit dhe të shtypit.¹⁴

¹² Neni 22 i Kushtetutës shprehet: “Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar. Censura paraprake e mjeteve të komunikimit ndalohej. Ligji mund të kërkojë dhënien e autorizimit për funksionimin e stacioneve të radios ose të televizionit.” Neni 23 i Kushtetutës garanton në mënyrë të veçantë lirinë e informimit: “E drejta e informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.”

¹³ Kushtetuta përcakton se këto kufizime duhet të jenë “në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë” dhe se “në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

¹⁴ Neni 19, “Shqipëria: Gjetjet paraprake të Misionit të Përbashkët për Lirinë e Medias”, aksesuar më 11.12.2020, <https://www.article19.org/resources/albania-preliminary-findings-of-joint-freedom-of-expression-mission/>

A është hartuar legjislacioni për mediat nëpërmjet një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës në konsultim me shoqatat përkatëse profesionale?

Në dhjetor 2019, Qeveria miratoi dy projektligje për rregullimin e medias, që ndërmerre një seri ndryshimesh në Ligjin Nr. 97/2013, "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligjin Nr. 9918, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".¹⁵ Ndryshimet në Ligjin e Mediave Audiovizive u referuan si "ligji për mediat online" dhe u kundërshtuan gjerësisht nga shoqëria civile, organizatat e medias si dhe rrjetet dhe shoqatat rajonale e ndërkombëtare të mediave, sepse ndryshimet parashikonin t'i kompetenca të mëdha Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) për të rregulluar përmbajtjen e medias, duke pasur parasysh se pavarësia dhe profesionalizmi i këtij autoriteti nuk mund të siguroheshin, gjë që e kthente këtë autoritet në një instrument censure. Ligji u kthye mbrapsht nga Presidenti i Shqipërisë dhe u refuzua edhe nga Komisioni i Venecias¹⁶ që kritikuan në përgjithësi se ligji mund të kufizonte lirinë e shprehjes dhe lirinë e mediave online. Që nga shtatori i vitit 2020,¹⁷ ligji është duke u shqyrtuar nga qeveria shoqëruar me shqetësimet që lidhen me numrin e kufizuar të konsultimeve dhe përfshirjen e pakët të aktorëve të interesuar në këtë proces.¹⁸ Që nga dhjetori i vitit 2020, këto dy projektligje janë ende nën rishqyrtim nga Qeveria.

A ka pasur përpjekje nga autoritetet shtetërore për të vendosur kërkesa të rrepta licencimi ose kërkesa të tjera për krijimin e mediave të shkruara dhe online? A shkojnë këto kërkesa përtej një regjistrimi të thjeshtë biznesi dhe te organet tatimore?

Ndonëse legjislacioni shqiptar nuk garanton shprehimisht lirinë e shprehjes për mediat online, të drejta të tilla garantohehen brenda kuadrit ligjor për mediane të shkruara dhe atë audiovizive. Nuk ka asnjë ligj që detyron licencimin e mediave të shkruara dhe atyre online përveç regjistrimit të biznesit dhe te organet tatimore. Portalet online regjistrojnë domenin e tyre tek Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, i cili u kërkon atyre të japin informacione bazë për pronësinë dhe informacione kontakti. Nëse portalet e reja kryejnë veprimtari ekonomike, të tilla si reklama dhe abonime, ato duhet të regjistrohen tek organet tatimore. Të dhënat për pronësinë e mediave mund të merren nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Nëse botuesi është ent jofitimprurës, ai duhet të regjistrohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Aktualisht, nuk ka asnjë përkufizim ligjor për mediat online. Projektligji i përfolur tenton të japë një përkufizim për "publikimin elektronik". Projektligji për mediat audiovizive (e ashtuquajtura paketa anti-shpifje ose ligji i mediave online) i detyron mediat online të regjistrohen zyrtarisht tek AMA, vetëm nëse duan të kenë lehtësira fiskale (neni 37/1), por ky projektligj është duke u rishqyrtuar aktualisht në dritën e opinionit të Komisionit të Venecias.

A ka pasur përpjekje nga autoritetet shtetërore për të kufizuar të drejtën e aksesit në Internet ose për të kërkuar bllokimin ose filtrimin e materialeve në internet?

Në Shqipëri, arsytet kryesore për kufizimet e mundshme të lirisë së shprehjes të rregulluara me ligj janë shpifja, gjuha e urrejtjes, materiali i mbrojtur nga e drejta e autorit dhe mbrojtja e të dhënave. Me krijimin e bazës së të dhënave online nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) në vitin 2020, ofruesit e shërbimit të internetit (ISP) tani do të informohen automatikisht për të gjitha vendimet përkatëse që merren nga autoritetet kompetente për heqjen e materialeve të paligjshme. Zbatimin e vendimeve të tilla do ta monitorojë Autoriteti për Komunikime Elektronike dhe Postare (AKEP)¹⁹. Në vitin 2020, ka pasur disa raste të kufizimeve arbitrare

15 Në Ligjin për mediat online, i njohur edhe si paketa e anti-shpifjes përshihen ndryshime të 30 neneve të Ligjit aktual për Mediat Audiovizive, veçanërisht në lidhje me kompetencat e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) dhe 4 neneve të Ligjit "Për Komunikimet Elektronike" (AKEP). Ky ligj i miratua nga Kuvendi në dhjetor 2019 pavarësisht se kundërshtohet gjerësisht nga BE, CoE, OSBE, gazetarë, organizata vendase dhe ndërkombëtare të mediave dhe nga eurodeputetët. Presidenti e ktheu ligjin në Parlament për rishqyrtim në janar 2020 me arsyetimin se ai shkel lirinë e shprehjes. Në fund të janarit, qeveria u tërhoq nga rivotimi i nismës dhe deklaroi se do të presë mendimin e Komisionit të Venecias.

16 Këshilli i Evropës, Komisioni i Venecias, "980/2020 – Shqipëri – Opinion për Projekt Amendamentet për Ligjin Nr. 97/2013, Për mediat audiovizive", aksesuar më 24.04.2021, <https://rm.coe.int/vc-opinion-albania-062016809ec9c9>

17 Ani Ruci, "Shqipëri: Paketa ligjore Anti-Shpifje sërish në qendër të debatit." Deutsche Welle, 19.09.2020, aksesuar më 15.03.2021, <https://www.dw.com/sq/shqip%C3%ABri-paketa-ligjore-anti-shpifje-s%C3%ABrish-n%C3%AB-qend%C3%ABr-f%C3%AB-debatit/a-54985644>

18 Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt, "Qeveria shqiptare ka në plan të miratojë ligjin e shumë-debatuar në përpjekje për të kontrolluar mediat online", aksesuar më 15.05.2021; <https://safejournalists.net/portfolios/albanian-government-plans-to-enact-highly-disputed-law-attempting-to-control-online-media/>

19 Eral Nazifi dhe Michael J. Oghia, "Qeverisja me internet në Shqipëri dhe roli i saj në lirinë e medias"; Tiranë: Rrjeti Ballkanik i Raportimit Investigativ në Shqipëri, 2020, f. 72, aksesuar më 15.03.2021, <https://bim.eu.com/wp-content/uploads/2020/08/Internet-Governance-1.pdf>

të materialeve të mediave online për motive të përgjithshme si përhapja e panikut në publik në rastet e dy emergjencave: tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe pandemia COVID-19, siç ilustron në shembujt më poshtë.

Me arsyetimin se përhapnin panik te publiku në situatën emergjente të periudhës së pas tërmetit, Autoriteti për Komunikimet Elektronike dhe Postare mbylli disa portale ueb, të perceptuar gjerësisht si kritike të qeverisë. Një grua e moshës 25 vjeç u arrestua dhe u mbajt në paraburgim për katër ditë nga drejtoria e policisë kundër terrorizmit, pasi shpërnda një artikull të një medie të huaj në lidhje me një shpërthim të mundshëm të depozitave të gazit natyror gjatë lëkundjeve të tërmetit dhe nëpërmjet të cilit i kërkohej autoriteteve të bënin një vlerësim të menjëhershëm të situatës.²⁰

Rrjeti Ballkanik i Raportimit Investigativ (BIRN) raporton se në disa raste kërkesa e AMA-s për AKEP-in për të bllokuar një nëndomen të caktuar që transmetonte materiale të paligjshme ka sjellë pasojë të paparashikuara, ku disa ISP bllokuan përkohësisht materiale për nëndomene të njohura. Në prill 2020, p.sh., një kërkesë e AMA-s për të bllokuar një faqe të caktuar të publikuar në platformën e njohur të gazetarisë online [Medium.com](https://www.medium.com) – krijuesi i së cilës kishte ngarkuar dhe kishte filluar transmetimin e një kopje piratë të një filmi nga komediani shqiptar Ermal Mamaqi – çoi në bllokimin e përkohshëm të të gjithë platformës nga disa ISP. Si përgjigje, Këshilli Shqiptar i Medias e kritikoi bllokimin e [Medium.com](https://www.medium.com) si censurë. Më vonë, AMA i tha BIRN Shqipëri se që prej asaj kohe ka hartuar një procedurë të brendshme për të shmangur probleme të tilla.²¹

Në vitin 2020, qeveria nuk kufizoi apo ndërpreu aksesin në internet, si, p.sh., autorizimin e mbylljes së pjeshme apo të plotë të internetit apo censurimin e materialeve online. Nuk ka raporte të besueshme që të kenë monitoruar komunikimet private online pa autoritetin e duhur ligjor.²²

A po i kryen autoriteti rregullator funksionet e tij në një mënyrë të pavarur dhe jo-diskriminuese? A administrohen rregulloret për licencimet dhe rregulloret e tjera të transmetimit në një mënyrë të drejtë dhe të paanshme?

Autoriteti i Mediave Audiovizive është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë. Performanca e tij si autoritet rregullator është karakterizuar nga debatet politike në lidhje me pavarësinë e këtij autoriteti dhe praktikave të punës, veçanërisht në lidhje me paketën e propozuar anti-shpifje, licencimin dhe monitorimin e mediave audiovizive.²³ Sipas projektligjit për mediat audiovizive (e ashtuquajtura paketë anti-shpifje ose ligji i mediave online), gama e kompetencave të AMA-s zgjerohet, por Komisioni i Venecias shprehu frikë se sanksionet administrative të parashikuara në rast shkeljesh ose abuzimesh janë kaq të larta sa që disa media të vogla mund të detyrohen të mbyllen për shkak të gjobave të ekzagjeruara. Ligji parashikon ngritjen e një Këshilli Ankesash për të ndërhyrë në rastet e ankesave të përmbajtjeve të botuara nga media. Projektligji parashikon që vendimet e AMA-s mund të ankimohen në Gjykatën Administrative. Raporte të ndryshme argumentojnë se AMA nuk ka qenë në gjendje të funksionojë e pavarur nga politika.²⁴ Të gjithë anëtarët e AMA-s kanë përkatësi të pastër politike, duke qenë se anëtarët e këtij autoriteti propozohen nga partia/koalicioni në pushtet që ka shumicën e vendeve në Kuvend.²⁵ Në vitin 2020, AMA funksionoi me një numër të kufizuar anëtarësh, ku tre nga shtatë vendet e bordit drejtues mbetën bosh. Raporti vjetor i AMA-s për vitin 2020 u botuan në maj të vitit 2021.²⁶

20 Komisioni Evropian. Raporti për Shqipërinë 2020, f. 31, aksesuar më 20.01.2021, https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/sites/near/files/albania-report_2020.pdf

21 Ermal Nazifi dhe Michael J. Oghia, "Qeverisja me internet në Shqipëri dhe roli i saj në lirinë e medias", Tiranë: Rrjeti Ballkanik i Raportimit Investigativ në Shqipëri, 2020, f. 74, aksesuar më 15.03.2021, <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2020/08/Internet-Governance-1.pdf>

22 Departamenti i Shtetit i ShBA-ve, "Raporti i të drejtave të njeriut në Shqipëri", 2019, aksesuar më 15.03.2021, <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2020/02/ALBANIA-2019-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf>

23 Rapo Zguri, "Marrëdhëniet mes medias dhe politikës në Shqipëri", Tirana, Instituti Shqiptar i Medias dhe FES, 2017, aksesuar më 15.03.2021, <http://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2020/05/shqip-marredheniet-mes-medias.pdf>

24 Agim Doksani et al., "Media in Tranzicion: Shënime pas tre dekadash", Tirana, Instituti Shqiptar i Medias dhe FES, 2020, aksesuar më 25.05.2021, <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/17277.pdf>

25 Këshilli i Evropës, Komisioni i Venecias, "980/2020 – Shqipëri – Opinion për Projekt amendamentet në Ligjin Nr. 97/2013 për mediat audiovizive", aksesuar më 24.04.2021, <https://rm.coe.int/vc-opinion-albania-0620/16809ec9c9>

26 Autoriteti i Mediave Audiovizive në Shqipëri, "Raporti vjetor 2020", aksesuar më 15.05.2021, http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Raport-Vjetor-i-AMA_2020.pdf

A abuzohet me dispozitat ligjore për reklamat shtetërore në media për të ndikuar politikisht te politika e tyre editoriale?
A është transparente, e drejtë dhe jo-diskriminuese ndarja e fondeve shtetërore?
A i publikojnë rregullisht institucionet shtetërore të dhënat për shumata e akorduara për media të ndryshme?

Burimi kryesor i financimit nga shteti për mediat private është financimi që jepet për transmetimin e reklamave ose njoftimeve shtetërore, ose financimi për ngjarje publike apo fushata publicitare. Kriteret e akordimit të këtyre fondeve nuk janë të përcaktuara. Gjithsesi, në vitet e fundit, mediat private të transmetimeve kanë marrë fonde për investimet në teknologji për fikjen e sinjalit të transmetimeve analoge.²⁷ Institucionet shtetërore nuk publikojnë rregullisht të dhëna për fondet specifike që u akordojnë mediave të ndryshme. Ministria e Financave dhe Ekonomisë publikon të dhëna për të gjitha pagesat e bëra nga institucionet publike për kontraktorët privatë. Ka mungesë transparence për paratë që shpenzohen përmes ndërmarrjeve të mëdha shtetërore, si ato për shërbimet komunale. Po ashtu, kur paratë shpërndahen përmes agjencive publicitare, nuk është e qartë se si u akordohen organeve të medias këto para. Nga ana tjetër, janë përkeqësuar edhe procedurat e transparencës në lidhje me procesin e prokurimit të reklamave shtetërore për mediat, duke bërë që të lindin pretendime për procese të njëanshme dhe diskriminuese. Po ashtu, ka shumë të ngjarë që reklamat shtetërore apo fondet publike për mediat të keqpërdoren dhe të synojnë të imponojnë në një farë mase programin e partisë politike në pushet.²⁸ Në përgjithësi, fondet shtetërore për reklama në mediat janë në rënie. Gjithsesi, mediat në mënyrë të tërthortë përfitojnë nga fondet, projektet apo favore të tjera që shteti mund t'u japë pronarëve dhe bizneseve të tyre, siç janë licencat, lejet e ndërtimit dhe përfitime të tjera që vijnë nga tenderët publikë. Varësia e mediave nga këto burime financimi ka bërë që politika e tyre editoriale të ndikohet dhe të jetë e njëanshme.²⁹

A ka ndonjë lloj subvencionimi ose fonde për mediat për prodhimin e përmbajtjes mediatike me interes publik dhe si zbatohen ato në praktikë?

Nuk ka asnjë subvencion apo fonde për mediat për të prodhuar përmbajtje mediatike me interes publik. Gazetarët, stafi i mediave dhe shoqatat e mediave kanë argumentuar nevojën për dhënien e subvencioneve të tilla për të mbështetur programimin e larmishëm të mediave. Veçanërisht me pandeminë COVID-19 në vitin 2020, shoqatat e mediave ngritën zërin për subvencione për stafin e mediavë, por kjo kërkesë u refuzua që në fillim. Gjithsesi, shtatë kompani mediatike u zgjodhën për të marrë kredi me interes të subvencionuar nga shteti me vlerë 144.5 milion lekë (1,175,250 euro).³⁰ Në listë bëjnë pjesë disa nga kompanitë apo grupet mediatike më të mëdha në Shqipëri, si Tv Klan, me pronar Aleksandër Frangajn; MTSC, me pronar Karlo Bollinon; Panorama Group, Focus Media News, dhe Focus Press, në pronësi të Irfan Hysenbelliut.³¹

Cilat janë mekanizmat për financimin e mediave në gjuhët e pakicave kombëtare?

Ligji për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare u njehtë drejtën e minoriteteve për të përdorur shtypin dhe mediat elektronike në gjuhën e tyre amtare, duke zbatuar rregullat e përcaktuara në ligjin për mediat, pa u diskriminuar në bazë të gjuhës së tyre, trashëgimisë etnike dhe kulturore. Gjithashtu, radio dhe televizioni publik duhet të transmetojnë në një nga kanalet e tyre lajme dhe programe kulturore në gjuhën e minoriteteve (Neni 20).³² Në vitet e fundit nuk janë hartuar apo zbatuar politika shtetërore për pakicat dhe mediat. Sipas ligjit në fuqi për pakicat kombëtare, buxheti i shtetit duhet të dedikojë çdo vit një fond special për minoritetet, që duhet të administrohet nga Komiteti i Pakicave Kombëtare. Për momentin është tepër herët për të gjykuar se çfarë ndikimi do të ketë ky fond në krijimin e mediave për pakicat kombëtare.³³ Radiotelevizioni publik RTSH transmeton në kanalën e dytë programe në

27 Aleksandra Bogdani, "Qeveria paguan faturën e dixhitalizimit: mbi 5 milionë euro për mediat private", Reporter, Mars 2017, aksesuar më 24.06.2021, <https://www.reporter.al/qeveria-paguan-faturen-e-dixhitalizimit-mbi-5-milione-euro-per-mediat-private/>

28 Po aty.

29 IREX, "Indeksi i Qëndrueshmërisë së Medias 2019 – Gjurmimi i zhvillimit të mediave të qëndrueshme të pavarura në botë.", aksesuar më 15.05.2021, <https://www.irex.org/sites/default/files/pdf/media-sustainability-index-europe-eurasia-2019-albania.pdf>

30 Aleksandra Bogdani, "Pasanikët" e Shqipërisë korri ndihmat për COVID-19 pavarësisht zotimeve të qeverisë për të kundërtën", Balkan Insight, korrik 2020, aksesuar më 24.06.2021, <https://balkaninsight.com/2020/07/15/albanias-moneyed-men-reap-covid-relief-despite-government-vow/>

31 Po aty.

32 Ilda Londo, "Media shqiptare dhe standardet evropiane", Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias, 2018, f. 28, aksesuar më 15.05.2021, <http://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2020/05/Media-shqiptare-dhe-standardet-evropiane.pdf>

33 Po aty.

pesë gjuhë të huaja për pakicat kombëtare në vend, si greke, malazeze, maqedonase, rome dhe vllahe.³⁴

A është e garantuar dhe e mbrojtur në mënyrë efikase autonomia dhe pavarësia e transmetuesit publik? A parashikon kuadri financiar pavarësinë dhe qëndrueshmërinë e tij? A përfaqëson shoqërinë në përgjithësi organi mbikëqyrës i këtij transmetuesi?

Radiotelevizioni shqiptar (RTSH) është transmetuesi më i vjetër i shërbimeve publike në Shqipëri. Në parim, ligji garanton autonominë dhe pavarësinë e RTSH-së. Megjithatë, shndërrimi i RTSH-së nga media shtetërore në transmetues të shërbimit publik³⁵ ka pasur mjaft vështirësi për shumë arsye, të tilla si konfigurimi i brendshëm i RTSh si organizatë mediatike dhe situata e përgjithshme e mediave në Shqipëri.³⁶ Transformimi dhe reforma e RTSH mbeten një punë e papërfunduar, ndërkohë që lidhjet e këtij transmetuesi me aktorët politikë pengojnë pavarësinë dhe performancën në përgjithësi. RTSH financohet nga publiku, kryesisht përmes një tarife të veçantë që paguhet nga çdo familje përmes faturës së energjisë elektrike. Drejtuesit e RTSh-së janë akuzuar edhe për korrupsion dhe shpërdorim detyre për keqpërdorimin e fondeve në dispozicion. Gjithsesi, askush nga drejtuesit i tij nuk është marrë i pandehur apo dënuar për krime të tilla. Disa auditime nga Kontrolli i Lartë të Shtetit kanë ngritur dyshime për menaxhimin e dobët të financave publike të këtij transmetuesi.³⁷

A2 Efektet e Ligjit të Shpifjes te gazetarët

A janë dispozitat ligjore për shpifjen të rrepta dhe mbrojtëse për zyrtarëve të shtetit? Cilat janë mangësitë kryesore të këtyre ligjeve?

Në Shqipëri, dhe në kundërshtim me praktikat më të mira ndërkombëtare, shpifja është një kundërvajtje penale.³⁸ Në Kodin Penal në fuqi shpifja përkufizohet si “Përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër, duke e ditur se janë të rreme, që cenojnë nderin dhe dinjitetin e personit.” Sipas këtij Kodi shpifja dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion e pesëqind mijë lekë. Kodi Penal u rishikua dhe u hoq dënimi me burg deri në dy vjet për shpifjen.³⁹ Edhe Kodi Civil ka dispozita për shpifjen. Në vitin 2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë shqyrtoi 13 raste për kundërvajtjen penale të shpifjes dhe 62 padi civil për shpifje në vitet 2018 dhe 2019. Pothuajse gjysma e këtyre proceseve gjyqësore kishin në shënjestër gazetarët dhe mediat.⁴⁰ Po ashtu, edhe përpjekjet e qeverisë për të propozuar një ligj të ri duke rritur më tej dënimin për shpifje shihet si kufizim i lirisë së shprehjes.⁴¹

Në dhjetor 2020, qeveria u përpoq të fuste ndryshime në Kodin Penal në lidhje me shpifjen duke propozuar të kriminalizonte memet satirike dhe postimet e tjera në internet.⁴² Ky propozim kishte të bënte me një rritje tejet të madhe të gjobave për shpifje dhe riformulimin e kundërvajtjes për ta bërë më të lehtë shpalljen e njerëzve fajtorë. Gjoha u propozua të rritej në 36,000 Euro⁴³ për shpifjet dhe përgjegjësia për veprën penale do të shkonte përtej gazetarëve duke përfshirë edhe

34 Komisioni Europian, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf> f. 31

35 Ligji për Mediat Audiovizive të vitit 2013 krijoi bazën ligjore për funksionimin e transmetuesve të shërbimit publik në Shqipëri. RTSH përcaktohet si transmetues i shërbimeve mediatike publike që ofron transmetim audioviziv falas dhe që aksesohet lehtë nga e gjithë popullata. Ligji përcakton përgjegjësinë e transmetuesit të shërbimeve publike dhe objektivat e tij të veçantë për funksionimin e tij (neni 91 dhe neni 118, Ligji Nr. 97/2013). Ligji i ri është në përputhje me legjislacionin e BE, një proces harmonizimi që po vazhdon ende.

36 Blerjana Bino, Radio Televizioni Shqiptar – Drejt Medias së Shërbimit Publik: Zgjerimi drejt multimedias online dhe rimodelimi i marrëdhënieve me audiencën. ANALITIKA. Aksesuar më 15.03.2021: <https://www.analitika.ba/sites/default/files/publikacjje/PSB%20Albania%20-%20policy%20brief%20FINAL.pdf>

37 Monitorimi i pronësisë së mediave në Shqipëri: Radio dhe Televizioni Shqiptar. Aksesuar më 15.03.2021: <https://albania.mom-rsf.org/en/owners/companies/detail/company/the-albanian-radio-television-rtsh/>

38 Exit News, “Koment i Exit: Nuk ka nevojë për ligje të tjera kundër shpifjes”, Exit shpjegon Shqipërinë, 18.12.2019, aksesuar më 15.03.2021, <https://exit.al/en/2019/12/18/exit-comment-no-need-for-additional-anti-defamation-laws/>

39 Ermal Nazifi dhe Michael J. Oghia, “Qeverisja me internet në Shqipëri dhe roli i saj në lirinë e medias”, Tiranë: Rrjeti Ballkanik i Raportimit Investigativ në Shqipëri, 2020, aksesuar më 15.03.2021, <https://bjm.eu.com/wp-content/uploads/2020/08/Internet-Governance-1.pdf>

40 Po aty.

41 Intervistë me ekspertin e medias, dhjetor 2020.

42 Erisa Kryeziu, “Media në shënjestër”: Ndryshimet në Kodin Penal rrisin gjokat ndaj shpifjes, status i veçantë politikaneve dhe gjyqtarëve”, Citizen Channel, 04.12.2020, aksesuar më 15.03.2021, https://citizens-channel.com/2020/12/04/media-ne-shenjester-ndryshimet-ne-kodin-penal-rrisin-gjokat-ndaj-shpifjes-status-i-vecante-politikaneve-dhe-gjyqtareve/?fbclid=IwAR2B9Vi5_HH-AJ-VKxS-SkaHkx7N37XtAYEpsU1Q3mUznY6CNk5caY6RY

43 Gjergj Erebara, “Qeveria shqiptare përsëri në lëvizje për të rritur gjokat për shpifje”, Balkan Insight, 04.12.2020, aksesuar më 15.03.2021: <https://balkaninsight.com/2020/12/04/albania-government-proposes-vet-another-antimedia-law/>

redaktorët dhe drejtorët e mediave.⁴⁴ Ky ndryshim i propozuar shkon përtej një regjistrimi të thjeshtë si biznes dhe te organet tatimore dhe konsiderohet nga shoqëria civile, organizatat e mediave dhe ekspertët si një tjetër përpjekje e qeverisë për të kufizuar lirinë e medias.

Sa procese gjyqësore janë hapur kundër gazetarëve nga zyrtarë të shtetit dhe politikanë gjatë vitit të kaluar?

Në vitin 2020, u hapën më shumë se dhjetë procese gjyqësore kundër gazetarëve, kryesisht për shpifje. Në disa raste është kërcënuar pavarësia e punës së gazetarëve në Shqipëri përmes rritjes së numrit të proceseve gjyqësore kundër tyre, veçanërisht kundër gazetarëve investigativë. Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (që njihen me termin "Paditë SLAPP") po bëhen më të shpeshta në peizazhin mediati në Shqipëri si mekanizëm për të censuruar, frikësuar apo heshtur median e pavarur, gazetarët investigativë dhe kritikët duke i ngarkuar atyre barrën e kostove të mbrojtjes ligjore deri në braktisjen e kundërshtimit apo kritikës.⁴⁵ Sipas të dhënave të Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, në vitin 2020 u konfirmuan dymbëdhjetë padi kundër gazetarëve. Vetëm në dhjetor 2020 ka pasur tre padi SLAPP në Shqipëri, duke kontribuar kështu në përkeqësimin e lirisë së medias.

Sa të motivuara politikisht janë vendimet e gjykatave ndaj gazetarëve? Çfarë lloj dënimesh janë dhënë?

Ekspertët e medias, organizatat e shoqërisë civile dhe organizata të tjera të pavarura të mediave kanë reaguar duke theksuar se proceset gjyqësore për shpifje kundër gazetarëve kanë bazë të vogël ligjore por po përdoren si mekanizëm për të frikësuar dhe censuruar investigimin e korrupsionit.⁴⁶ Politikanët dhe përfaqësuesit e bizneseve të mëdha zakonisht hapin procese të tilla gjyqësore në një përpjekje për të bërë të heshtin gazetarët investigativë ose mediat kritike.⁴⁷

A e njohin gjykatat mekanizmin vetë-rregullues të krijuar (nëse ka)? A e pranojnë ato si të vlefshëm një përgjigje, korrigjim ose falje të botuar ose shpërndarë?

Në vitin 2020 Aleanca Shqiptare për Media Etike hartoi mekanizmat e vetë-rregullimit.⁴⁸ Kjo është në përputhje me atë që kanë argumentuar profesionistët dhe ekspertët e medias se rregullimi efikas i mediave online kërkon më shumë vetë-rregullim më të fortë sesa kontrollin e punës së tyre nga institucionet e qeverisë.⁴⁹ Gjyqtarët janë familjarizuar më shumë me profesionin e gazetarëve dhe përgjithësisht njohin mekanizmat vetë-rregullues të mediave, siç janë pranimi si të vlefshëm korrigjimin e përmbytjes, kërkimi i faljes ose tërheqja e përmbytjes. Megjithatë, nuk ka një bazë të dhënash të plotë për vendimet e gjykatave ndaj mediave në mënyrë që të jemi në gjendje të vlerësojmë plotësisht vlefshmërinë e mekanizmave vetë-rregullues në procedurat ligjore. Sipas Kodit Civil, në rast se një person shpallet fajtor për publikimin e informacionit të pasaktë e të rremë për një person tjetër, gjykata urdhëron që ky person të kërkojë falje publike. Prandaj, në këtë drejtim, kjo lloj praktike njihet edhe me ligj.

Çfarë mendojnë gazetarët për ligjin e shpifjes? A dekurajohen ata për të hetuar e për të bërë shkrime kritike?

Gazetarët dhe ekspertët e medias argumentojnë se situata aktuale po kontribuon në përkeqësimin e lirisë së medias, duke penguar kështu punën e tyre të pavarur, gazetarinë investigative dhe përmbytjen e medias kritike.⁵⁰ Media e pavarur në vend përballet me presione, kërcënime dhe rreziqe të formave të ndryshme dhe kanë nevojë për mbështetje për t'i dalë kundër pushtetit abuziv.⁵¹ Reporterët kanë fare pak siguri në punë dhe mbeten pre e proceseve gjyqësore,

44 Gjergj Erebara, "Tjetër propozim antimedia, kërkohet mjegullim i kodit penal dhe rritje e gjobave për shpifje", Reporter, 03.12.2020. Aksosuar më 15.03.2021: <https://www.reporter.al/jeter-propozim-antimedia-kerkohet-mjegullim-i-kodit-penal-dhe-rritje-e-gjobave-per-shpifje/>

45 Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias, Përgjigje e Shpejtë e Lirisë së Medias, "Shqipëri: Kompanitë private nuk janë imune nga vëzhgimi i shtypit dhe ne dënojmë të gjitha përpjekjet për të përdorur veprime ligjore për të shënjestruar gazetarët", aksosuar më 15.03.2021, <https://www.ecpmf.eu/albania-private-companies-are-not-immune-from-press-scrutiny-and-we-condemn-all-attempts-to-use-legal-actions-to-target-journalists/>

46 Përfundime nga diskutimet në fokus grupe në dhjetor 2020.

47 Intervistë me organizatën e shoqërisë civile mediatike, nëntor 2020.

48 Aleanca për Media Etike u krijua në Shqipëri në Shkurt 2020 me qëllim angazhimin aktiv të mediave, veçanërisht atyre online, për të respektuar Kodin Etik të Gazetarëve. Në vijim të angazhimit të saj për të përmirësuar mjedisin etik të medias në Shqipëri, JUFREX 2, një Projekt i përbashkët KIE/BE mbi "Lirinë e Shprehjes dhe Lirinë e Medias në Shqipëri", mbështeti Aleancën në hapin e saj vendimtar për t'u bërë një mekanizëm funksional për vetë-rregullim. Më 1 tetor, 16 anëtarë të Aleancës u takuan për të diskutuar rrugën përpara. Ata zgjodhën Bordin e Etikës dhe miratuan logon e Aleancës.

49 Intervistë me profesionist të medias, dhjetor 2020.

50 Përfundime të diskutimeve në fokus grupe në dhjetor 2020.

51 Instituti Ndërkombëtar i Shtypit, "IPI dënon ndalimin dhe sulmin ndaj gazetarëve që dokumentojnë dhunën policore në Shqipëri", aksosuar më 15.12.2020, <https://ipi.media/ipi-condemns-detention-and-assault-of-journalists-documenting-police-violence-in-albania/>

kërcënimeve dhe sulmeve të herëpashershme fizike nga ata që vihen nën lupën e mediave.⁵²

A3 Mbrojtja ligjore e pluralizmit politik në media

A është rregulluar pluralizmi politik në media me ndonjë ligj të veçantë për mediat jashtë proceseve zgjedhore? Cilat janë detyrimet e transmetuesit të shërbimeve publike dhe cilat janë ato të transmetuesve privatë në lidhje me pluralizmin politik jashtë proceseve zgjedhore?

Pluralizmi politik në media nuk është i rregulluar me ligj të veçantë për mediat jashtë procesit zgjedhor përveç Transmetuesit të Shërbimit Publik. Pavarësisht kësaj, ka parime të përgjithshme të paanshmërisë që rregullojnë punën e operatorëve të shërbimit të mediave, ku ligji thotë se operatorët e transmetimeve audiovizive mund të transmetojnë veprimtarinë e forcave politike, por ato duhet ta bëjnë këtë gjë pa treguar njëanshmëri politike. Transmetuesi i Shërbimit Publik është i detyruar të ruajë pluralizmin politik jashtë procesit zgjedhor, por mediat private nuk janë të detyruar me ligj për një gjë të tillë. Ligji për mediat audiovizive thotë se Bordi i Transmetuesit të Shërbimit Publik duhet të monitorojë dhe garantojë paanshmërinë e informacionit. Po ashtu, dispozita për paanshmërinë janë përfshirë edhe në Statutin dhe Politikën Editoriale të TSHP-së, ndërkohë që udhëzimet editoriale të këtij transmetuesi bëjnë thirrje për pluralizëm pikëpamjeje/opinionesh dhe raportim të balancuar. Tradicionalisht, kanalet e TSHP-së në Shqipëri prirën të mbështesin partinë politike në pushet.⁵³ Shqipëria vlerësohet me rrezik mesatar (53%) për sa i përket mbrojtjes së pluralizmit të medias. Edhe pse kuadri rregullator që garanton lirinë e shprehjes është i mirë, mungesa e zbatimit të tij sjell si rezultat vlerësimet e rrezikut të mesëm e të lartë në shumë vlerësime.⁵⁴

A është i detyruar autoriteti rregullator të monitorojë dhe mbrojë pluralizmin politik përtej procesit zgjedhor?

Ligji për mediat audiovizive përcakton se autoriteti rregullator, AMA, mbikëqyr paanshmërinë, objektiviteten dhe tërësinë e informacionit audiovizive.⁵⁵ AMA nuk mbikëqyr gjendjen e pluralizmit politik tek mediat përtej procesit zgjedhor, përveç Transmetuesit të Shërbimit Publik. Madje edhe në këtë rast, ky monitorim lidhet më shumë me parimet e përgjithshme që duhet të respektohen nga transmetuesit. AMA raporton për sasinë e kohës televizive që i jepet çdo subjekti, përfshirë reklamat institucionale (në kohë dhe numër), me atributet e autoritetit monitorues të transmetimit të përmbajtjes nga subjektet audio dhe audiovizive.⁵⁶ AMA publikon rregullisht raporte monitorimi në lidhje me mbikëqyrjen e përmbajtjes dhe të shpeshësisë, por nuk është e fokusuar vetëm te pluralizmi politik.

A kanë akses të paanshëm dhe të barabartë te mediat partitë politike dhe kandidatët e tyre përtej procesit zgjedhor?

Edhe pse Kushtetuta garanton lirinë e shprehjes, ndërthurja e interesave të fuqishme të biznesit, politikës dhe medias pengon zhvillimin e mediave të pavarura. Pjesa më e madhe e tyre konsiderohen se mbështesin Partinë Socialiste ose Partinë Demokratike⁵⁷. Si rezultat, jo të gjitha partitë politike dhe kandidatët kanë akses të paanshëm dhe të barabartë te mediat, veçanërisht te mediat kryesore audiovizive.

Cilat janë detyrimet ligjore të mediave gjatë fushatave zgjedhore? Cili organ monitoron mediat elektronike dhe shtypin?

Kodi Zgjedhor garanton akses pa pagesë në kohë transmetimi në kanalet dhe shërbimet e TSHP-së për aktorët politikë gjatë fushatave zgjedhore dhe ai zbatohet

52 Gjergji Vurmo, "Liria në Botë 2020: Shqipëria", aksesuar më 15.05.2021, <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2020>

53 Intervistë me ekspertin e medias, nëntor 2020.

54 Kristina Voko et al., "Monitorimi i Pluralizmit të Mediave në Epokën Dixhitale: Zbatimi i Monitorit të Pluralizmit të Mediave në Bashkimin Evropian, Shqipëri dhe Turqi në Vitet 2018-2019: Raporti i Vendit për Shqipërinë", Badia Fiesolana: Instituti i Universitetit Evropian, 2020, aksesuar më 15.03.2021, https://cadmus.eu.eu/bitstream/handle/1814/67816/albania_results_mpm_2020_cmpf.pdf?sequence=1&isAllowed=y

55 Ligji Nr. 97/2013, datë 4.3.2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", aksesuar më 15.03.2021, <http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/LIGJI-NR-972013-%E2%80%99CP%3%8B-MEDIAT-AUDIOVIZIVE-N%3%8B-REPUBLIK%3%8B-N-E-SHQIP%3%8BRIS%3%8B%E2%80%9D-I-NDRYSHUAR.pdf>

56 Autoritetit i Mediave Audiovizive në Shqipëri, "Raporti vjetor 2020", f. 39, aksesuar më 15.05.2021, http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Raport-Vjetor-I-AMA_2020.pdf

57 Gjergji Vurmo, "Liria në Botë 2020: Shqipëria", aksesuar më 15.05.2021, <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2020>

në mënyrë efektive⁵⁸. Kodi përcakton që radiot dhe televizionet private mbulojnë fushatën zgjedhore vetëm gjatë edicioneve normale dhe speciale të lajmeve, dhe stacionet televizive duhet të zbatojnë një raport të barabartë kohor për të gjitha partitë parlamentare që në zgjedhjet e fundit për në Kuvend kanë marrë deri në 20% të vendeve. AMA dhe Misioni i OSBE/ODHIR për zgjedhjet në Shqipëri mbikëqyrin mediat elektronike për mbulimin e fushatës elektorale. Nuk ka monitorim të mediave të shkruara në këtë drejtim. Aktualisht, AMA nuk monitoron mediat elektronike, madje as për mbulimin e fushatave zgjedhore. Mandati i saj aktual përfshin vetëm mediat audiovizive. Projektligji për mediat audiovizive (e ashtuquajtura paketa anti-shpifje ose ligji i mediave online) i propozuar nga qeveria, i cili nuk është miratuar ende, do t'i jepte atributë AMA-s për të monitoruar edhe mediat elektronike.

A kanë akses të drejtë e të barabartë te mediat partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatave zgjedhore?

Ligji parashikon akses të drejtë e të barabartë te mediat për partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatave zgjedhore. Pavarësisht dispozitave ligjore, grupe të ndryshme aktorësh politikë përfaqësohen në mënyrë të njëanshme dhe të pabarabartë, duke favorizuar qartazi disa aktorë politikë ndaj të tjerëve⁵⁹. Në zgjedhjet vendore të vitit 2019, sipas OSBE/ODHIR, Partia Socialiste në pushtet dhe Partia Demokratike e opozitës zunë pjesën më të madhe të lajmeve në të gjitha mediat e monitoruara. Po ashtu, mbulimi i zgjedhjeve u la në hije nga kriza politike, ku lajmet dhe debatet televizive përqendroheshin më shumë në luftën e ashpër politike mes drejtuesve të PD-së dhe PS-së.⁶⁰ Përveç kësaj, kandidatet dhe politikanet gra patën një mbulim shumë të kufizuar gjatë fushatës.

A4 Liria e punës dhe shoqatës së gazetarëve – garancitë ligjore dhe praktika

A iu kërkohet gazetarëve të licencohen? A ka pasur përpjekje në vitin e kaluar për të vendosur licesa të tilla nga shteti?

Gazetarët nuk kanë nevojë të jenë të licencuar nga shteti për të punuar. Gjatë vitit të kaluar, nuk ka pasur asnjë përpjekje nga ana e shtetit për të prezantuar licesime të tilla.

A u është refuzuar gazetarëve e drejta për të raportuar një ngjarje të caktuar për shkak të mosakreditimit?

Për shkak të kufizimeve të pandemisë COVID-19, gazetarët nuk mund të raportojnë nga seancat gjyqësore. Për më tepër, edhe pse teknologjia bën të mundur mbajtjen e konferencave të shtypi nëpërmjet platformës ZOOM ose platformave të tjera, institucionet shëndetësore pranonin pyetje vetëm me shkrim gjatë mbylljes së vendit. Problemi në Shqipëri është se numri i ngjarjeve, konferencave për shtyp dhe platformave të tjera ku gazetarët mund të marrin pjesë dhe të bëjnë pyetje është në rënie, duke pasur parasysh se Qeveria dhe partitë politike përgatisin material të gatshme dhe mediat thjesht i transmetojnë ato. Ka pasur raste kur gazetarëve u është refuzuar e drejta për të raportuar një ngjarje gjatë periudhës së zgjedhjeve apo edhe në raste të tjera. Edhe në konferencat për shtyp dhe ngjarje të tjera të Kryeministrit ose të zyrtarëve të tjerë të qeverisë, ka raste që gazetarëve nuk u lejohet të marrin pjesë në këto takime për të bërë pyetje.⁶¹

A janë gazetarët të organizuar në shoqata profesionale dhe nëse po në ç'mënyrë? A ka presione mbi organizatën e tyre ose mbi anëtarët e organizatës?

Gazetarët janë të organizuar në shoqata profesionale, por këto shoqata nuk janë të konsoliduara dhe kanë mangësi në burime dhe kompetenca. Unioni i Gazetarëve Shqiptarë ka rreth 1,200 anëtarë dhe ka ngritur degë në 10 qytete të Shqipërisë. Shoqata e Gazetarëve Profesionalistë Shqiptarë ka rreth 220 anëtarë dhe një bord me 12 gazetarë. Është anëtar i asociuar i Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve.

58 Kristina Voko et al., "Monitorimi i Pluralizmit të Mediave në Epokën Dixhitale: Zbatimi i Monitorit të Pluralizmit të Mediave në Bashkimin Evropian, Shqipëri dhe Turqi në Vitet 2018-2019: Raporti i Vendit për Shqipërinë", Bacia Fiesolana: Instituti i Universitetit Evropian, 2020, aksesuar më 15.03.2021: https://cadmus.eui.eu/bitstream/handle/1814/67816/albania_results_mpm_2020_cmpf.pdf?sequence=1&isAllowed=y

59 Po aty.

60 ODHIR, "Raporti përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve 2019", f. 19, aksesuar më 15.03.2021, https://www.osce.org/files/f/documents/1/f/429230_0.pdf

61 Intervistë me profesionistë të medias, qershor 2020.

A janë gazetarët të organizuar në sindikata dhe, nëse po, si? A ka presione mbi drejtuesit e sindikatave dhe anëtarët e tjerë? A janë gazetarët të lirë të bëhen anëtarë të sindikatave?

Nuk ka sindikata të gazetarëve në Shqipëri. E krijuar në vitin 2005, Unioni i Gazetarëve Shqiptarë është shoqata më e madhe e gazetarëve në Shqipëri. Gazetarët janë të lirë të bëhen anëtarë të sindikatave, por Unioni i Gazetarëve Shqiptarë është në thelb opsioni i vetëm. Në vitin 2020 nuk është raportuar asnjë presion që mund t'u jetë bërë drejtuesve të Unionit. Në këtë vit, nuk ka pasur as nisma të reja për të krijuar një sindikatë gazetarësh. Sindikatat e tjera në Shqipëri nuk kanë një seksion të veçantë për punonjësit e medias dhe gazetarët. Nuk ka sindikatë as tek Transmetuesi i Shërbimit Publik. Gjithsesi, shumë prej gazetarëve që punojnë në këtë transmetues janë anëtarë të Unionit të Gazetarëve Shqiptarë.

A ka ndonjë Këshill Shtypi dhe si është i organizuar ai? A u bëhen presione përfaqësuesve të këtij Këshilli Shtypi?

Këshilli Shqiptar i Medias është një organizatë e pavarur e gazetarëve, e regjistruar në 2015 si OJQ në formën e një shoqate që ka si synim një media më etike, profesionale dhe më të pavarur. Anëtarët themelues të Këshillit janë më shumë se tridhjetë gazetarë shqiptarë nga TV, media e shkruar dhe online. Këshilli Shqiptar i Medias përpiket të nxisë zbatimin e Kodit të Etikës⁶² në media në Shqipëri, publikuar në 2018 nga Instituti Shqiptar i Medias. Në vitin 2020, Këshilli Shqiptar i Medias krijoi Aleancën për Media Etike si një mekanizëm vetë-rregullimi dhe prezantoi "Udhëzimet Etike për Gazetarinë Online"⁶³. Aleanca për Media Etike është një grup vullnetar i mediave shqiptare e angazhuar për zbatimin rigoroz të Kodit të Etikës për Gazetarët.⁶⁴

A5 Mbrojtja ligjore e burimeve të gazetarëve

Si garantohet nga legjislacioni konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve? Në cilat rrethana mund t'i nënshtrohet kufizimeve e drejta për të mbrojtur burimet e tyre? A garantohet me Kushtetutë e drejta për mbrojtjen e burimeve?

Mbrojtja e burimeve konfidenciale të informacionit është një nga parimet themelore të punonjësve të medias, sipas dispozitave të ligjit për mediat. Veç kësaj, Neni 159 i Kodit të Procedurës Penale i përfshin gazetarët mes profesioneve që nuk janë të detyruar ta zbulojnë burimin e informacionit, duke e konsideruar atë sekret profesional. Megjithatë, me vendim gjykatë mund të provohet se burimi i informacionit është provë themelore dhe gazetarëve mund t'u kërkohet zbulimi i tij. Gazetarët kanë detyrimin etik që të mos zbulojnë burimet e tyre të informacionit⁶⁵. Sipas Kodit të Etikës së medias në Shqipëri, "Gazetarët nuk duhet të bëjnë publik emrin e një personi që ka dhënë informacion në konfidencialitet, veç rasteve kur personi në fjalë ka dhënë pëlqimin shprehimisht."⁶⁶ Gjykata mund t'u kërkojë gazetarëve me anë të një urdhri me shkrim të zbulojnë burimin konfidencial të informacionit nëse është në interes të publikut.

A e respektojnë autoritetet konfidencialitetin e burimeve të gazetarëve? A ka shembuj ku gazetarët urdhërohen të zbulojnë burimet e tyre dhe a arsyetohet ky urdhër me mbrojtjen e interesit publik?

Në Shqipëri, konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve është sfidë më vete edhe për faktin se Shqipëria është një vend i vogël dhe lidhjet shoqërore dhe familjare janë shumë të forta. Mediat vendore, në veçanti, e kanë të vështirë t'i mbrojnë burimet e informacionit.⁶⁷ Ka pasur raste kur autoritetet (gjyqësore) kanë urdhëruar zbulimin e burimeve, por si pjesë e hetimeve zyrtare dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

62 Kodi i Etikës së Gazetarit mund të gjendet i plotë në adresën: <https://kshm.al/kodi-i-etikes-se-gazetarit/>

63 Udhëzime Etike për Gazetarinë Online gjenden në adresën: <https://kshm.al/wp-content/uploads/2018/04/UDH%c3%8bZIME-ETIKE-P%c3%8bR-GAZETARIN%c3%8b-ONLINE-3.pdf>

64 Për më shumë informacion për Aleancën për Media Etike vizitoni: <https://aleancaetike.media/about-us/>

65 Për më shumë informacion: <https://www.reporter.al/manualidrejtisesie/BURIMET%20DHE%20GAZETARI.html>

66 Kodi i Etikës së Gazetarit mund të gjendet i plotë në adresën: <https://kshm.al/kodi-i-etikes-se-gazetarit/>

67 Intervistë me profesionist të medias lokale, nëntor 2020.

A ka pasur sanksione ndaj gazetarëve që kanë refuzuar të zbulojnë identitetin e burimit të tyre?

Në vitin 2020, nuk u regjistrua asnjë rast sanksionesh ndaj gazetarëve që refuzuan të zbulonin identitetin e burimit. Në 2016, u konfirmua të paktën një rast, ai i gazetarit Artan Hoxha, ndaj të cilit prokuroria nisi një hetim për shkak të refuzimit nga ana e gazetarit për të zbuluar identitetin e burimit të tij.

A ndjehen të lirë gazetarët të kërkojnë akses dhe të mbajnë kontakte me burimet e informacionit?

Siguria e gazetarëve për të aksesuar dhe mbajtur kontaktet me burimet e informacionit bëhet më e vështirë nga problemet në përgjithësi me sigurinë e gazetarëve dhe kushtet e tyre të punës. Gazetarët që mbulojnë krimin e organizuar dhe gazetarët investigativë hasin më shumë vështirësi gjatë kërkimit të aksesit dhe mbajtjes së kontakteve me burimet e informacionit.

A6 Mbrojtja e së drejtës për akses tek informacioni

Cilat janë rregullat ligjore për akses tek informacioni dhe dokumentet zyrtare që kanë lidhje me gazetarët?

Transparenca e institucioneve publike shqiptare rregullohet nga Ligji Nr. 119/2014, 'Për të Drejtën e Informimit.' Ligji përcakton kërkesat për transparencës nga autoritetet publike, dispozitat për kërkesa për të drejtën e informimit dhe mekanizmat e monitorimit. Ka afate të përcaktuara qartë për autoritetet publike për të dhënë informacionin e kërkuar. Nëse autoritet publik dështon ose refuzon të japë informacionin e kërkuar pa dhënë arsye, personi që kërkon informacionin ka të drejtë të paraqesë një ankesë te Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, i cili mund të gjobisë autoritetin publik ose ta detyrojë atë të japë informacionin e kërkuar. Megjithatë, autoritetet publike mund të mos e japin informacionin e kërkuar, nëse ky informacion ka të bëjë ose ndikon negativisht në sigurinë kombëtare, sekretet tregtare, të drejtën e privatësisë, të drejtën e autorit, marrëdhëniet ndërqeveritare, politikat monetare dhe fiskale, vazhdimin e hetimeve penale ose administrative dhe konsultimet

ndërqeveritare për zhvillimin e politikave publike.⁶⁸ Pavarësisht këtyre kufizimeve, ligji thotë se informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij. Gjithsesi, dispozita për "interesin publik", është e papërcaktuar, duke u dhënë kështu institucioneve publike liri të konsiderueshme për të kufizuar ose refuzuar me ligj dhënien e informacionit.⁶⁹ Megjithatë, për të hedhur dritë mbi këtë të drejtë mund të përdoret jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

A i përdorin këto rregulla gazetarët? A i respektojnë pa vonesa këto rregulla autoritetet?

Kërkesa për marrje informacioni sipas Ligjit për të Drejtën e Informimit është instrumenti kryesor që kanë në dispozicion gazetarët për të marrë informacion. Megjithatë, kjo do të thotë që gazetarëve do t'u duhet të presin 10 ditë pune që është afati maksimal ligjor që u jepet nga ligji institucioneve për t'iu përgjigjur kërkesë për informim⁷⁰. Kjo mund të shkaktojë vonesa në raportimin e gazetarëve. Prandaj, këta të fundit priren të përdorin burime të tjera informacioni. Po ashtu, edhe institucionet publike priren të përdorin afatin më të gjatë të mundshëm që u jep ligji për t'iu përgjigjur kërkesave; madje i vonojnë përgjigjet për to. Raportohen raste ku autoritetet nuk zbatojnë ligjin dhe nuk respektojnë të drejtën për informim.⁷¹

A janë autoritetet shtetërore në përgjithësi transparente? A krijojnë ato marrëdhënie të hapura, jodiskriminuese dhe të paanshme me mediat apo tentojnë të punojnë në fshehtësi? A i trajtojnë institucionet shtetërore me preferencë mediat politikisht miqësore me ta?

Në studimet e fundit⁷² argumentohet se mungon kultura e hapjes nga ana e institucioneve publike, gjë që evidentohet si shqetësim jo vetëm nga organizatat e

68 Neni 17, Ligji për të drejtën e informimit, 119/2014, aksesuar më 24.06.2021, https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Ligji_119_2014_18.09.2014.pdf

69 Fondacioni Westminster për Demokraci, "Pjesëmarrja e shoqërisë civile në vendimmarrje në Shqipëri", aksesuar 15.02.2021 <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2020/03/Pjesemarrja-e-OSHC-ne-Vendimmarrje-ne-Shqiperi-1.pdf>

70 Neni 15, Ligji për të drejtën e informimit, 119/2014, aksesuar më 24.06.2021, https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Ligji_119_2014_18.09.2014.pdf

71 Marjo Brakaj, "Gjashtë muaj pandemi, shumë pikëpyetje dhe refuzim ligji nga "shëndetësia", Fakte, shtator 2020, aksesuar më 24.06.2021, <https://faktoje.al/gjashte-muaj-pandemi-shume-pikepyetje-dhe-refuzim-ligji-nga-shendetesia/>

72 Leonie Vrugtman dhe Blerjana Bino, "Besimi në qeverisje, sondazhi i opinionit 2019", Tiranë: UNDP dhe IDM, 2020, aksesuar më 15.03.2021: https://www.al.undp.org/content/dam/albania/NewPublications/trust_in_governance_al.pdf

shoqërisë civile (OSHC) por edhe nga institucionet e pavarura, siç është Komisioneri për Parandalimin e Diskriminimit. Intervistat me OSHC sugjerojnë se problemi kryesor që i pengon OSHC-të të kontribuojnë denjësisht në hartimin e politikave është pikërisht natyra hermetike dhe e papërgjegjshme e institucioneve publike. Angazhimi selektiv dhe tendenca për të kufizuar çdo informacion prodhojnë marrëdhënie asimetrike qeveri-shoqëri civile. Kjo asimetri strukturore çon në qëndrim prej padroni dhe mospërfillës ndaj OSHC-ve nga ana e zyrtarëve dhe institucioneve publike.

A janë transparente gjykatat? A sigurohet akses i medias tek procedurat ligjore në mënyrë jo-diskriminuuese dhe pa kufizime të panevojshme?

Me reformën kryesore gjyqësore në proces e sipër, akses i medias te proceset ligjore sigurohet përgjithësisht në mënyrë të paanshme dhe pa kufizime sipas parashikimeve të ligjit. Gjithsesi, gazetarët vërejnë se prania e mediave te seancat dhe takimet e mbajtura nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në disa raste është e kufizuar. Për shembull, seancat dëgjimore që u mbajtën për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë ishin me dyer të mbyllura dhe nuk u publikuan as regjistrimet audio dhe as procesverbalet. Nga ana tjetër, gazetarët theksojnë se në vitin 2020 edhe akses i procedurat gjyqësore ishte i kufizuar për shkak të pandemisë COVID-19.

A sigurohet pjesëmarrja e publikut në punimet e Kuvendit? A ka kufizime ndaj gazetarëve për të ndjekur punën e Kuvendit?

Punimet e Kuvendit transmetohen drejtpërsëdrejti nga televizioni publik si dhe janë të hapura për publikun duke ndjekur procedurat e vendosura. Për shkak të kufizimeve të COVID-19, hyrja në seancat e Parlamentit në vitin 2020 nuk ishte gjithmonë e mundur. Në përgjithësi, gazetarët argumentojnë se transparenca e Parlamentit është përmirësuar duke marrë parasysh mekanizmat institucionalë të vendosur dhe aksesin tek burimet online krijuar nga Parlamenti për mediat, OSHC-të dhe grupet e tjera të interesit. Kuvendi ka punësuar dy persona për këtë qëllim: njëri është Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe tjetri është Koordinatori për Shoqërinë Civile dhe Grupet e Interesit⁷³. Kuvendi publikon një raport vjetor për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe së fundmi ka krijuar një Koordinator për Transparencën dhe ka përmirësuar praninë e tij në internet edhe si pasojë e pandemisë COVID-19.⁷⁴

Sa të hapur me publikun janë qeveria dhe ministritë e saj?

Në përgjithësi, gazetarët e konsiderojnë Qeverinë dhe ministritë e saj si jo shumë të hapura dhe transparente. Në një studim të fundit⁷⁵ argumentohet se një problem i madh që u vu re gjatë tërmetit shkatërrimtar dhe krizës së pandemisë COVID-19 ka të bëjë me aksesin tek informacioni publik dhe transparenca e institucioneve. Duhet të theksohet se krizat i nxorën edhe më shumë në pah problemet ekzistuese të transparencës dhe besimit në institucione.

73 *Fondacioni Westminster për Demokraci, "Pjesëmarrja e shoqërisë civile në vendimmarrje në Shqipërisë", aksesuar 15.02.2021, <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2020/03/Pjesemarrja-e-OSHC-ne-Vendimarrje-ne-Shqiperi-1.pdf>*

74 *Po aty.*

75 *Blerana Bino et al., "Roli i shoqërisë civile dhe medias në menaxhimin e krizave në Shqipëri", Tiranë: Fondacioni Westminster për Demokraci, 2020, aksesuar më 15.03.2021, <https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2020/12/Roli-i-Shoq-civ-media-final.pdf>*

B1 Kufizimet ekonomike për lirinë e gazetarëve

Sa gazetarë kanë nënshkruar kontrata pune? A u paguhen të plota sigurimet shoqërore e shëndetësore? Sa të mira janë pagat e gazetarëve? A paguhen rregullisht?

E drejta e punës e gazetarëve në Shqipëri u vështirësua edhe më tej në vitin 2020 për shkak të pandemisë COVID-19 dhe vështirësive ekonomike të mediave⁷⁶. Siç është evidentuar edhe nga studimet e mëparshme,⁷⁷ mungesa e kontratave të punës mbetet problem, veçanërisht për gazetarët e rinj dhe ata që punojnë për mediat online. Pagesat e sigurimeve janë ende problem shqetësues, veçanërisht mungesa ose leja e kufizuar e lindjes për të dy prindërit. Paga mesatare e gazetarëve është rreth 500-600 Euro në muaj, por që shkon maksimum edhe 1,800 Euro në muaj dhe minimumi 250 Euro në muaj. Rregullsia e pagesave është një problem veçanërisht për gazetatat, mediat online dhe ato lokale.

76 Julian Hoxhaj, "Sfidat e medias lokale gjatë COVID-19", *Instituti Shqiptar i Medias*, aksesuar më 15.03.2021, <http://www.institutemedi.org/wp-content/uploads/2020/06/Sfida-e-medias-lokale-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri-gjat%C3%AB-pandemis%C3%AB-Covid-converted.pdf>

77 IDRA, "Tregu i punës në media në Shqipëri 2019", aksesuar më 15.03.2021, <https://idracompany.com/files/ALB-Studimi%20mbi%20hendekun%20e%20aft%C3%ABsive%20n%C3%AB%20media.pdf>

Në vitin 2020, në disa media audiovizive humbën punën rreth 30 punonjës, mbi 1,000 të tjerë patën ulje page prej 25-50%, ndërkohë që vonesat e pagave mujore u bënë diçka e zakonshme. Gazetarët që punojnë pa kontratë individuale përbëjnë mbi 90% të trengut mediatik, një pjesë e madhe punojnë me kontrata kolektive dhe shumë pak punojnë në të zezë.⁷⁸

Në ç'gjendje janë kushtet e punës së gazetarëve? Cilat janë problemet më të mëdha që hasin në vendin e punës?

Kushtet e punës së gazetarëve janë të vështira dhe lidhen me mosrespektimin e kushteve të punës, të tilla si mohimi i pushimeve të paguara, abuzimi verbal në vendin e punës dhe diskriminimi për shkak të gjinisë ose bindjeve politike; mungesa e sigurisë gjatë ushtrimit të detyrës; problemet e sigurisë në lidhje me raportimin e krizave të tilla si tërmeti, COVID-19, përmblytjet, protestat, etj.⁷⁹ Gazetarët e mediave online raportohen më shpesh se punojnë në të zezë (pa kontrata pune) dhe në kushte anonimati. Kjo gjë nuk u bën të mundur atyre të mbrojnë të drejtat e autorit dhe as të krijojnë një profil personal profesional, për t'u bërë kështu pjesë e barabartë e komunitetit të gazetarëve profesionistë.⁸⁰ Shkelja e të drejtës së autorit është problem i madh edhe në mediat audiovizive, ajo shkruara dhe ato online.

B2 Pavarësia editoriale në mediat private

A kanë të miratuara mediat private rregulla organizative sipas të cilave redaksitë janë të ndara dhe të pavarura nga drejtuesit dhe drejtorja e marketingut?

Madhësia e mediave ndryshon, por pjesa më e madhe e tyre janë të vogla dhe me burime të kufizuara, ku i njëjti person mund të ushtrorë funksione të ndryshme. Prandaj, ndarja e redaksisë nga drejtuesit dhe marketingu nuk është gjithmonë e mundur.⁸¹ Pak media

të mëdha private kanë të miratuar, të paktën në letër, rregulla organizative për të siguruar pavarësinë editoriale duke i ndarë redaksitë nga drejtuesit dhe drejtorja e marketingut. Gjithsesi, mediat e vogla po tentojnë të krijojnë dhe konsolidojnë redaksitë e lajmeve të ndara dhe të pavarura nga drejtuesit dhe drejtorja e marketingut.

A kanë miratuar mediat rregulla të tjera për të ruajtur pavarësinë editoriale nga pronarët dhe organet drejtuese? A respektohen këto rregulla?

Shumë pak media, veçanërisht ato kritike dhe investigative, bëjnë përpjekje për të ruajtur pavarësinë editoriale duke i nxitur gazetarët të zhvillojnë aftësitë, të trajnohen dhe të shkëmbejnë përvojën me kolegët e tjerë. Forma të tjera të ruajtjes së pavarësisë editoriale janë prezantimi i kodit bazë të etikës në redaksinë dhe në media dhe marrja e vendimeve si grup në lidhje me çështjet delikate për raportimin dhe prodhimin e përmbajtjes.⁸² Në pjesën më të madhe të rasteve, mediat private nuk i nxisin gazetarët të marrin pjesë në trajnime për zhvillimin profesional. Gazetarët që dëshirojnë ta marrin pjesë në trajnime të tilla duhet të përdorin kohën e tyre të lirë dhe fondet personale. Megjithatë, në përgjithësi, nuk ka rregulla të tjera të miratuara nga media private për ruajtjen e pavarësisë nga pronarët dhe organet drejtuese të medias. Kjo mbetet një nga sfidat më të mëdha për të gjitha mediat private në Shqipëri.

A kanë redaksitë e lajmeve të mediave private kode të brendshme etike apo respektojnë një kod të përgjithshëm etike?

Në përgjithësi, mediat private nuk kanë politikë të shkruar për standardet e etikës apo kode të miratuara etike, por ato respektojnë standardet e përcaktuara nga Këshilli i Shqiptar i Medias⁸³ apo shoqata të tjera gazetarësh në vend.⁸⁴

Cilat janë format më të zakonshme të presionit që pronarët dhe drejtuesit e mediave ushtrorin mbi redaksitë apo mbi gazetarët?

Format më të zakonshme të presionit që pronarët dhe drejtuesit e mediave ushtrorin mbi redaksitë apo mbi gazetarë të caktuar janë mbyllja e emisioneve ose

⁷⁸ Enton Abilekaj, Drejtor i *Dosja.al*, cituar nga Ani Ruci, "Në Shqipëri "gazetarët mund të pushohen me një sms", *Deutsche Welle*, 29.04.2020, aksesuar më 15.03.2021: <https://www.dw.com/sq/n%C3%AB-shqip%C3%ABri-gazetar%C3%ABt-mund-t%C3%AB-pushohen-me-nj%C3%AB-sms/a-53278560>

⁷⁹ Valbona Sulçe Kolgeci dhe Endrit Shabani, "Raport Studimor mbi të Drejtat e Punës së Gazetarëve", Tiranë: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 2020, aksesuar më 15.03.2021, https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor-Te-drejta-pune-per-gazetarët_ALB-1.pdf

⁸⁰ Intervistë me profesionist të medias, janar 2021.

⁸¹ Fokus grup me mediat lokale, dhjetor 2020.

⁸² Po aty.

⁸³ Instituti Shqiptar i Medias, "Kodi i Etikës së Gazetarit në Shqipëri", 2018, aksesuar më 15.03.2021, <https://kshmi.al/kodi-i-etikes-se-gazetarit/>

⁸⁴ Fokus grup me mediat lokale, dhjetor 2020.

anulimi i raportimeve ose formateve të tjera të lajmeve/ përmbajtjes, kërcënimi, pasiguria ekonomike, ngacmimi, kontrolli mbi përmbajtjen dhe mashtrimi. "Gazetarët po vihen në kushte mbijetese ekonomike dhe kanë presion në rritje nga pronarët e kompanive mediatike që në Shqipëri janë kryesisht biznesmenë me interesa dhe lidhje politike."⁸⁵

Cili ishte shembulli më tipik i presionit të ushtruar nga pronarët apo drejtuesit e mediave mbi një redaksi të tërë ose gazetarë të caktuar gjatë vitit të kaluar?

Nuk ka asnjë informacion publik për presionin e ushtruar nga pronarët apo drejtuesit e mediave ndaj një redaksie të tërë ose gazetarëve të caktuar gjatë vitit të kaluar. Në intervistat dhe diskutimet në fokus grupe, gazetarët hezituan të jepnin detaje të plota në lidhje me raste të tilla. Megjithatë, Këshilli Shqiptar i Medias ka konfirmuar se në Shqipëri "gazetarët mund të pushohen nga puna thjesht me një mesazh SMS nga pronarët e mediave."⁸⁶ Unioni i Gazetarëve Shqiptarë vëren se një rast i tillë në vitin 2020 do të ishte pa dyshim ulja në detyrë e gazetares Beti Njuma në Ora News, nga Drejtore e Informacionit në vetëm spikere dhe moderatore e lajmeve. Ky rast tregon ndërthurjen e interesave të politikës dhe me ato të medias.

B3 Pavarësia editoriale e transmetuesit të shërbimit publik

A ka të miratuar një kode sjelljeje për gazetarët dhe pavarësi editoriale transmetuesi i shërbimit publik? A e respektojnë gazetarët këtë kod?

Transmetuesi i Shërbimit Publik (TSHP) është i detyruar me ligj të ketë një kod sjelljeje dhe kod etike të miratuar si dhe të sigurojë pavarësinë editoriale. Gazetarët trajnohen për pavarësinë editoriale nga TSHP si dhe nga donatorët. Në vitin 2020, ky transmetues publikoi online kodin e etikës, parimet editoriale dhe standardet profesionale ku përshkruhej parimi kryesor i pavarësisë së tij editoriale përfshirë këtu edhe kodin

85 Koloreto Cukali, Kryetar i Këshillit Shqiptar të Medias, cituar nga Ani Ruci, "Në Shqipëri 'gazetarët mund të pushohen me një SMS'", Deutsche Welle, 29.04.2020, aksesuar më 15.03.2021, <https://www.dw.com/sg/n%C3%AB-shqip%C3%ABri-gazetar%C3%ABi-mund-t%C3%AB-pushohen-me-nj%C3%AB-sms/a-53278560>

86 Po aty.

e etikës dhe standardet profesionale.⁸⁷ Në praktikë, me gjithë përparimin e shndërrimit të RTSh-së në një media në shërbim të publikut, ajo ende perceptohet se favorizon partinë në pushtet në mbulimin e saj me lajme.⁸⁸

A kanë organet e TSHP rregulla të brendshme organizative për ta siguruar pavarësinë e redaksisë nga organet drejtuese të TSHP-së? A respektohen këto rregulla?

Në parim, TSHP e ka të ndarë redaksinë nga organet drejtuese. Sipas Ligjit për Mediat Audiovizive të vitit 2013, tre organet drejtuese të RTSh janë: Këshilli Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm, dhe Bordi i Administrimit (Ligji Nr. 97/2013). Këshilli Drejtues është organi më i lartë drejtues, Drejtori i Përgjithshëm mbikëqyr menaxhimin e përditshëm dhe Bordi i Administrimit është bord këshillimor i Drejtorit të Përgjithshëm për çështje financiare dhe administrative, por që nuk lidhen me programin dhe përmbajtjen. Këto struktura supozohet të sigurojnë pavarësinë e redaksisë së bashku me politikën editoriale, kodin e etikës dhe standardet profesionale. Në praktikë, drejtuesit kanë tendencë të ndikojnë në punën e redaksisë dhe të gazetarëve.

Cilat janë format më të zakonshme të presionit që qeveria ushtron mbi redaksitë apo mbi gazetarët e Transmetuesit të Shërbimit Publik?

Në praktikë, transformimi dhe reforma e RTSH mbeten një punë e papërfunduar⁸⁹, ndërkohë që lidhjet e këtij transmetuesi me aktorët politikë pengojnë pavarësinë dhe performancën e tij në përgjithësi. Kjo është më se evidente në ngërçin për zgjedhjen e organeve drejtuese të RTSh-së (Këshillin Drejtues dhe Drejtorin e Përgjithshëm),⁹⁰ në përmbajtjen me njëanshmëri politike që përkon me interesat e partisë në pushtet,⁹¹ dhe në transparencën dhe llogaridhënien relativisht të

87 Kodi i etikës, parimet editoriale dhe standardet profesionale të RTSH gjenden në adresën: https://rtsh.s3.eu-central-1.amazonaws.com/4fe8d4a805a246d7a33ff6dc658036e9_202004071647.pdf

88 Diskutim në fokus grupe me gazetarë, dhjetor 2020.

89 Kjo sfidë përmendet në Raportin Vjetor të RTSH paraqitur në Kuvend në gusht 2020, gjendet në adresën: <http://www.parlament.al/Files/Kerkese/20200429155506RAPORT%20VJETOR%20%20i%20RTSH-s%C3%AB%20per%20vitin%202019-compressed.pdf>

90 Gjergj Erebara, "Opozita parlamentare" i hap rrugën kontrollit njëpartiak të AMA dhe RTSH", Reporter, 24.05.2021, aksesuar më 05.06.2021, <https://www.reporter.al/opozita-parlamentare-i-hap-rrugen-kontrollit-njepartiak-te-ama-dhe-rtsh/>

91 Fatjana Mejdini, "Transmetuesi publik përpiqet të mbajë qëndrim asnjëanshëm në zgjedhje", Balkan Insight, 01.06.2017, aksesuar më 15.03.2021, <https://balkaninsight.com/2017/06/01/albanian-public-broadcaster-balance-in-campaign-pin-hopes-for-change-05-31-2017/>

kufizuar për publikun, edhe pse kjo është përmirësuar me Programin e Transparencës dhe me raportet që publikohen online apo me një mbulim më të balancuar të fushatave elektorale në vitet 2017⁹² dhe 2021.

Cili ishte shembulli më tipik i presionit të ushtruar nga qeveria mbi të gjithë redaksinë ose te gazetarë të caktuar gjatë vitit të kaluar?

Nuk ka asnjë informacion publik për presionin e ushtruar nga qeveria mbi punën e redaksisë së lajmeve apo te gazetarë të caktuar gjatë vitit të kaluar. Gjatë intervistave dhe diskutimeve në fokus grupe, gazetarët hezituan të jepnin detaje të plota në lidhje me raste të tilla. Në vitin 2020, shoqatat e gazetarëve nuk patën asnjë reagim publik në lidhje me ndonjë shembull tipik të presionit që mund të ketë ushtruar qeveria në mënyrë të drejtpërdrejtë në punën e redaksisë së RTSH-së ose gazetarëve të saj.

B4 Pavarësia editoriale në mediat jofitimprurëse

A kanë të miratuar mediat jofitimprurëse një kod sjelljeje dhe të pavarësisë editoriale të gazetarëve? A e respektojnë gazetarët këtë kod?

Mediat jofitimprurëse kanë miratuar kodin e sjelljes së gazetarëve dhe gazetarët respektojnë pavarësinë editoriale. Këtu bëjnë pjesë media investigative, media fakt-verifikuese dhe zakonisht media të orientuara drejt misionit që i shërbejnë komunitetit dhe kështu përpiqen të respektojnë pavarësinë editoriale. Këto media përdorin Kodin e Etikës të botuar nga Instituti Shqiptar i Medias dhe/ose Këshilli Shqiptar i Medias.⁹³

Cilat janë format më të zakonshme të presionit mbi mediat jofitimprurëse?

Mediat jofitimprurëse në Shqipëri janë më të pakta në numër dhe më të vogla për sa i përket madhësisë në krahasim me mediat private. Gjithsesi, ato përballen me vështirësi të ngjashme në lidhje me lirinë e medias, qëndrueshmërinë financiare dhe sigurinë ashtu si edhe mediat e tjera. Për shembull, format më të zakonshme

të presionit mbi mediat jofitimprurëse janë mungesa e fondeve për prodhimin dhe zgjerimin e përmbajtjes; paditë SLAPP që përpiqen të frikësojnë dhe dekurajojnë raportimin investigativ; dhe mungesën e aksesit tek informacioni publik që lidhet me transparencën e kufizuar të institucioneve publike dhe me frikësimin e gazetarëve.

Cili ishte shembulli më tipik i presionit të ushtruar mbi mediat jofitimprurëse?

Rastet SLAPP në dhjetor 2020 kanë të bëjnë me partneritetin publik-privat të qeverisë në lidhje me inceneratorët në Elbasan. Në javën e parë të dhjetorit 2020, BIRN Albania u padit për artikuj që kishte botuar për marrëveshjen e inceneratorit. Çështja e dytë SLAPP është kundër gazetarit investigativ Artan Ramës, i cili botoi një artikull investigativ "Prapaskenat e një Kontrate të Dytë për Inceneratorin e Elbasanit" në 6 nëntor 2020. Më herët, Shefja e Kabinetit të Ministrisë së Mbrojtjes kishte paditur gazetaren Juli Ristani, e cila kishte botuar në gazetën 'Shqip' një artikull investigativ për akordimin e bursave për studime mjekësore ushtarake në Greq, të ofruara nga NATO.

BIRN Albania e mbrojti raportin duke thënë se është e gatshme për ta mbrojtur çështjen në gjykatë. Procesi gjyqësor erdhi pasi BIRN Albania publikoi një artikull rreth inceneratorëve. "Padia është dukshëm e papazë dhe dukshëm ka për qëllim të frikësojë gazetarët përmes proceseve të kushtueshme dhe të gjata ligjore në mënyrë që të ngurrojnë para se të raportojnë," tha Drejtoresha Ekzekutive e BIRN Albania, Kristina Voko për Citizen Channel. I pyetur nga BIRN Albania, Artan Rama tha se i qëndron artikullit të botuar dhe se do ta mbronte atë në gjykatë. "Mendoj se ka dy qëllime. E para, një tentativë e kompanisë për të prezantuar në publik një imazh pozitiv, pasi duke ia kaluar çështjen një gjykate (kompania) shpreson se mund të përcjellë publikisht, a priori, idenë se mbi të është bërë një padrejtësi dhe e dyta, një kërcënim për cilido gazetar që përfshihet në raportime lidhur me kontratat koncesionare të partneritet publik-privat, ku përfshihen këto kompani," tha Rama për Citizen Channel.

92 OSBE/ODHIR, "Gjetjet paraprake për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare 2021, aksesuar më 10.06.2021, <https://www.osce.org/files/f/ documents/2/7/484688.pdf>

93 Fokus grup me gazetarët, dhjetor 2020.

B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve

Sa liri kanë gazetarët në përzgjedhjen e lajmeve për të cilat punojnë dhe për të vendosur se cilin aspekt të lajmit duhet të nxjerrin në pah?

Gazetarët nuk janë gjithmonë plotësisht të pavarur në përzgjedhjen e lajmeve. Liria e gazetarëve në përzgjedhjen e lajmeve me të cilat punojnë dhe për të vendosur se cilat aspekte të një historie duhet të nxjerrin në pah varet nga politika editoriale e mediave, nga pozicioni i redaksisë ndaj pronarëve dhe drejtuesve dhe nga struktura e pronësisë së mediave dhe të të ardhurave. Përcaktues kryesor është edhe lloji i tregimit ose përmbajtjes që do të prodhohet. Vetëcensurimi është ende i pranishëm, gjë që mund të pasqyrohet në hartimin e lajmeve që mbuloohen. Në disa raste, redaktimi i përmbajtjes së artikujve ose fshirja e disa aspekteve të artikullit është praktikë e zakonshme në redaksi.

Sa shpesh marrin pjesë në takime koordinuese editoriale të redaksive (pjesëmarrjen në takimet e redaksisë apo caktimi i reporterëve)?

Në pjesën më të madhe të redaksive të lajmeve, gazetarët marrin pjesë çdo ditë në të paktën një takim koordinues të redaksisë, ku përcaktohen historitë/temat që do të trajtohen. Për mediat e vogla private, gazetarët nuk takohen domosdoshmërisht në një mjedis kaq të zyrtarizuar, por organizohen takime informale të atypëratyshme për të përcaktuar temat që do të trajtohen. Gjithsesi, gazetarët deklarojnë se shpesh ndodh që redaktorët t'u kërkojnë me ngulm të mos ndjekin histori të caktuara që një i fuqishëm mund të mos ta ketë me qejf. Po ashtu, në disa raste, gazetarëve u thuhet nga redaktorët ose edhe nga pronarët e mediave të tyre se kë të intervistojnë.

Cilat është qëndrimi i gazetarëve në lidhje me etikën e gazetarëve?

Gazetarët janë në favor të zbatimit të kodit së etikës së gazetarëve. Gjithsesi, jo të gjithë gazetarët janë të ndërgjegjësuar për kodin e etikës që ka të miratuar media e tyre. Po ashtu, disa gazetarëve u mungojnë kapacitetet dhe ndërgjegjësimi për të respektuar kodin e etikës, veçanërisht gazetarëve të rinj dhe atyre që punojnë në portale online dhe media të vogla private.

Cilat janë vetë-perceptimet e gazetarëve për nivelin e ndikimit tek ta të rreziqeve dhe të burimeve të ndryshme të ndikimit?

Gazetarët janë të ndërgjegjësuar për nivelin e ndikimit tek ta të rreziqeve dhe burimeve të ndikimit, veçanërisht siguria, presionet nga qeveria dhe forma tjetër e kërcënimit nga pronarët.

Sa gazetarë raportojnë censurë nga redaktorët? Sa gazetarë raportojnë se iu nënshtruan vetëcensurës për shkak të kërcënimit apo humbjes së vendit të punës ose për shkak të rreziqeve të tjera?

Censura dhe vetëcensura janë ende të pranishme në mjedisin mediatik shqiptar. Disa studime konfirmojnë se ato vijnë nga presionet politike dhe ekonomike, mungesa e qëndrueshmërisë financiare të mediave, mungesa e profesionalizmit dhe mungesa e etikës dhe e respektimit të të drejtave të gazetarëve. Në Shqipëri censura dhe vetëcensura janë më të zakonshme në mediat audiovizive dhe në shtyp që kontrollohen nga një pjesë e vogël e familjeve të fuqishme, të cilat kanë lidhje biznesesh në tregjet e rregulluara.⁹⁴ Mediat online janë më të larmishme. Ato janë në hapat e parë dhe në disa raste drejtohen nga gazetarë profesionistë, të cilët u japin më shumë liri gazetarëve për të raportuar histori nga këndvështrime të ndryshme. Të bllokuar mes interesave ekonomike të pronarëve dhe marrëdhënieve me qeverinë, gazetarët shpesh vendosin të mos e lëkundin varkën. Kjo klimë prodhon shumë vetëcensurë, duke pasur parasysh që përpjekjet e gazetarëve për t'u gërmuar më shumë mund të çojnë në humbjen e vendit të punës.⁹⁵

94 Safija Todorovic, "Qeverisje me Internet, Kyç i lirisë së medias në Shqipëri", *Balkan Insight*, 10.09.2020, aksesuar më 15.03.2021, <https://balkaninsight.com/2020/09/10/internet-governance-key-to-media-freedom-in-albania/>

95 Fatjona Mejdini, *gezetare, cituar nga Tsai Mali*, "Shqipëria, Gazetaria dhe Hija e Censurës", *Observatori Ballkanik e Caucaso Transeuropa*, 01.10.2019, aksesuar më 15.03.2021, <https://www.balcanicaucaso.org/eng/Areas/Albania/Albania-journalism-and-the-shadow-of-censorship-196741>

B6 Pozicioni ekonomik i grave gazetare

A punojnë gazetare femra në kushte më të këqija pune në krahasim me kolegët e tyre meshkuj? A kanë nënshkruar kontrata pune po aq shpesh sa edhe burrat?

Në përgjithësi, gratë gazetare raportojnë të njëjtat kushte pune si kolegët e tyre meshkuj, me ndryshimin e vetëm se gratë e gazetarisë raportojnë raste të ngacmimeve seksuale. Kontratat e punës që nënshkruajnë ato nuk ndërlidhen me gjininë e gazetarëve, por me vështirësitë e mëdha të mediave. Gazetaret femra ankohen edhe për mosdhënien e lejes së lindjes, gjë që ndikon në zgjedhjet që bëjnë për jetën e tyre.⁹⁶

A priren gratë të mbajnë pozicione drejtuese editoriale në redaksi po aq sa edhe burrat?

Gratë përfaqësojnë numrin më të madh të gazetarëve në Shqipëri. Gazetaret femra në Shqipëri nuk mbajnë pozicione drejtuese editoriale në redaksi në atë nivel sa edhe burrat. “Edhe pse gratë janë në numër më të madh në fakultetet e gazetarisë, më pak se gjysma e tyre punojnë në redaksi lajmesh. Në një industri të mbizotëruar nga meshkujt që gëlon nga seksizmi, gratë hasin çdo pengesë që u vihet në rrugën e tyre drejt karrierës. Për shembull, orari i punës së një gazetari është i gjatë dhe i parregulluar. Kjo do të thotë që, duke qenë se zakonisht kanë barrën më të madhe të kujdesit për fëmijët dhe për punët e shtëpisë, gratë e kanë të vështirë të përballen me këtë situatë.”⁹⁷ Nuk ka statistika zyrtare se sa redaktorë ka në Shqipëri dhe sa prej tyre janë gra.

Sa të larta janë pagat e tyre në krahasim me ato të meshkujve?

Sipas një studimi të fundit për të drejtat e punës së gazetarëve në Shqipëri, 80% e grave gazetare thonë se punojnë me kohë të plotë dhe besojnë se paguhen më pak se homologët e tyre meshkuj.⁹⁸ Nuk ka të dhëna të besueshme të ndara sipas gjinisë për pagat e gazetarëve femra dhe meshkuj.

A bëhen pre e presioneve të caktuara për shkak të gjinisë gazetaret femra?

Gazetaret femra raportojnë ngacmime seksuale dhe mohim të lejes së lindjes. Në diskutimet në fokus grupe, gazetarët raportojnë ngacmime seksuale në vendin e punës, kryesisht ndaj grave dhe vajzave duke marrë parasysh që menaxherët, redaktorët dhe pronarët janë përgjithësisht burra me “një qëndrim prej padroni dhe pushtetari ndaj gazetarëve të rinj që përpiqen të bëjnë një emër”.⁹⁹ Gjithsesi, raste të tilla nuk raportohen zyrtarisht dhe zakonisht nuk ngrihen akuza për shkak të një klime ku mbizotëron kërcënimi dhe një qëndrim i përgjithshëm të ‘fajësimit të viktimës’. Toleranca ndaj shkeljeve është e përhapur si tek punëdhënësit ashtu edhe te gazetarët, të cilët zakonisht e konsiderojnë veten si të pafuqishëm për të ndryshuar realitetin.

96 Valbona Sulçe Kolgeci dhe Endrit Shabani, “Raport Studimor mbi të Drejtat e Punës së Gazetarëve”, Tiranë: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 2020, aksesuar më 15.03.2021, https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor-Te-drejta-pune-per-gazetaret_ALB-1.pdf

97 Alice Taylor, “Koment: Gjithsesi, gazetaret femra ia dalin”, Exit shpjegon Shqipërinë, 06.03.2021, aksesuar më 15.05.2021, <https://exit.al/en/2021/03/06/comment-nevertheless-female-journalists-persisted/>

98 Valbona Sulçe Kolgeci dhe Endrit Shabani, “Raport Studimor mbi të Drejtat e Punës së Gazetarëve”, (Tiranë: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 2020), aksesuar më 15.03.2021: https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor-Te-drejta-pune-per-gazetaret_ALB-1.pdf

99 Fokus grupet, dhjetor 2020.



C1 Statistikat për sigurinë dhe pandëshkueshmërinë

Për sa i përket sigurisë së gazetarëve, ashtu si me tendencat e tjera në rajon, sulmet ndaj lirisë së medias rrezikojnë të bëhen një normalitet i ri në Shqipëri.¹⁰⁰ Në vitet 2019 dhe 2020, gazetarët janë qëlluar me armë automatike në shtëpitë e tyre, janë kërcënuar me armë zjarri, janë helmuar me gaz në rrugë, kanë marrë kërcënime me vdekje në televizion drejtpërsëdrejti, u janë revokuar lejet e qëndrimit, janë bërë shënjestër e fushatave të shpifjeve dhe janë paditur nga Kryeministri – vetëm sepse ushtronin profesionin e tyre.¹⁰¹ Raporti i Këshillit të Evropës (KiE) zbulon se në fund të dhjetorit 2020 kishte 6 raste aktive për Shqipërinë, 6 të tjerë që ishin zgjidhur dhe 1 vrasje.¹⁰² Që nga qershori i vitit 2020, statistikat e sigurisë dhe pandëshkueshmërisë janë publikuar edhe në Rrjetin e Gazetarëve të Sigurt me një total prej 17 rastesh.

100 Këshilli i Evropës, "Platformë për nxitjen e mbrojtjes së gazetarisë dhe sigurisë së gazetarëve", 2020, f. 35, aksesuar më 05.06.2021, <https://www.coe.int/en/web/media-freedom>

101 Alice Taylor, "Shqipëria bie shtate vende në raportin e njohur ndërkombëtar për lirinë e medias", Exit shpjegon Shqipërinë, 18.04.2019, aksesuar më 15.03.2021, <https://exit.al/en/2019/04/18/albania-drops-seven-places-in-internationally-respected-media-freedom-report/>

102 Këshilli i Evropës, "Platformë për nxitjen e mbrojtjes së gazetarisë dhe sigurisë së gazetarëve", 2020, f. 35, aksesuar më 05.06.2021, <https://www.coe.int/en/web/media-freedom>

Tabela 2: Numri i sulmeve të regjistruara ndaj gazetarëve në vitin 2020.

Kategoritë	Numri	Përshkrimi
<p>Kërcënime dhe ngacmime jo-fizike Në kërcënimet dhe ngacmimet jo-fizike bëjnë pjesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> Mbikëqyrje ose ndjekje; Ngacmim me thirrje telefonike; Ngacmim arbitrar gjyqësor ose administrativ; Deklarata agresive nga zyrtarë publikë; Forma të tjera presioni që mund të vënë në rrezik sigurinë e gazetarëve në vijimin e punës. <p>Këto lloj kërcënimesh nuk përfshijnë rrethimin apo bulizmin në mjedisin e punës.</p>	3	<ul style="list-style-type: none"> Në janar Acromax kërcënoi se do të padiste Alice Taylor dhe Exit.al për një investigim që kishin bërë për punën e kësaj kompanie për Partinë Socialiste në Shqipëri. Padi SLAPP në dhjetor 2020 në Shqipëri kundër gazetarit investigative Artan Rama Shefja e Kabinetit të Ministrisë së Mbrojtjes kishte paditur gazetaren Juli Ristani, e cila kishte botuar në gazetën 'Shqip' një artikull investigative për akordimin e bursave për studime mjekësore ushtarake në Greqi, të ofruara nga NATO.
<p>Kërcënimet kundër jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve Këtu përshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> Kërkesa për vrasjen e gazetarëve, miqve, familjes ose burimeve të gazetarëve; Kërkesa për dëmtime fizike kundër gazetarëve, miqve, familjes ose burimeve të gazetarëve; <p>Këto kërcënime mund të:</p> <ul style="list-style-type: none"> Bëhen drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet palëve të treta; Dërgohen me komunikim elektronik ose ballë për ballë; Jenë të drejtpërdrejta ose të nënkuptuara. 	1	<ul style="list-style-type: none"> Gazetari i Ora News Elio Laze publikoi një video ku kërcënohej nga një punonjës i Firmës së Ndërtimit Salillari. Punonjësi i Salillarit, një prej kompanive të preferuara të ndërtimit të qeverisë, u përgjigj duke u treguar agresiv verbalisht dhe fizikisht me gazetarin dhe duke e kërcënuar atë.
<p>Sulme faktike ndaj gazetarëve Llojet e sulmeve faktike mund të jenë dëmtimet fizike ose mendore, rrëmbimet, dhunimi i shtëpisë/zyrave, sekuestrimi i pajisjeve, ndalimi arbitrar, tentativa të dështuara për vrasje, etj.</p>	9	<ul style="list-style-type: none"> Në janar 2020, makina e gazetarit Fatos Lubonja u dëmtua me gur pasi e kishte parkuar jashtë në zonën e shtëpisë së tij në Tiranë. Pas prishjes së Teatrit Kombëtar në 17 maj 2020, redaktori i portalit Politiko.al, Alfred Lela, u arrestua me dhunë teksa raportonte për protestën. Karikaturisti Diversanti i Exit New ishte në teatër gjatë kohës që po shkatërrohej ndërtesa dhe u tërhoq me forcë e u arrestua nga forcat speciale, të cilat mësynë ndërtesën. Në 17 qershor Hila po filmonte prishjen e një ndërtese nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) në një plazh në Lezhë duke përdorur celularin e tij. Në 30 tetor 2020, pak pas mesnatës, një shpërthim tronditi shtëpinë e Eldion Ndreka, reporterit dhe gazetarit lokal të News24. Në momentin e shpërthimit, Ndreka ishte në shtëpi me familjen e tij. Shpërthimi shkaktoi vetëm dëme materiale. Më 11 dhjetor, policia ndaloi Xhoi Malësinë, gazetar dhe spiker i lajmeve në RTV Ora News, teksa filmonte protestat. Më 11 dhjetor, Qamil Xhani, kryeredaktor i gazetës Koha Jone, u arrestua teksa ishte në krye të detyrës. Redaktori i Durrës Lajm Shefqet Duka u ndalua nga policia teksa po largohej nga ambientet e medias pranë Sheshit Liria ku po zhvilloheshin protestat. Aldo Mustafa, gazetari lokal i Syri.net TV në qytetin e Durrësit ishte në detyrë duke raportuar drejtpërdrejt protestën në vendlindjen e tij kur u sulmua nga një prej policëve dhe nuk u lejua të filmonte dhe raportonte për ndalimin e protestuesve nga Policia.
<p>Vrasja e gazetarëve (në 15-20 vitet e fundit) Llojet e vrasjeve mund të jenë shkëmbim zjarri, vrasje me paramendim, shpërthim bombe, rrahje për vdekje, etj.</p>	1	<ul style="list-style-type: none"> Në 7 janar 2020, Kastriot Reçi, pronar i "Media Plus TV" u vra në Rrëshen të Mirditës. Në të njëjtën ditë, policia dha një deklaratë ku thuhet se "sot në 11:05, në Rrëshen të Mirditës, u vra me armë zjarri në rrethana të paqarta KR. Vrasësi nuk është identifikuar ende nga policia. Z. Reçi dyshohet se ishte i lidhur me trafikun e drogës.
<p>Kërcënime dhe sulme ndaj institucioneve, organizatave të medias dhe shoqatave të mediave dhe gazetarëve Sulme faktike ndaj pronave të organeve dhe organizatave të mediave, personelit të tyre, sekuestrim pajisjes, deklarata agresive nga zyrtarë publikë, etj. Po ashtu, në kërcënime dhe sulme të tilla mund të jenë edhe ato të kategorive të mësipërme.</p>	3	<ul style="list-style-type: none"> Policë të armatosur mësyjnë ndërtesën e Ora News. Sulm kibernetik ndaj Citizen Channel Ligji i mediave online ose paketa e anti-shpifjes

Janë identifikuar disa raste si kërcënim për punën e pavarur të gazetarëve në Shqipëri përmes ngritjes së proceseve gjyqësore kundër gazetarëve, veçanërisht gazetarëve investigativë. Padi të SLAPP (Padi të Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike) po bëhen të shpeshta në mediat shqiptare si mekanizëm për të censuruar, kërcënuar apo për të bërë të heshtin media të pavarura, gazetarë investigativë dhe kritikë duke iu ngarkuar atyre koston e mbrojtjes ligjore derisa të detyrohen braktisin investigimet apo kritikën.

Në janar Acromax kërcënoi se do të padiste Alice Taylor dhe [Exit.al](#) për një investigim që kishin bërë për punën e kësaj kompanie për Partinë Socialiste në Shqipëri, përfshirë këtu heqjen e përbajtjes nga platformat sociale si Facebook dhe YouTube. Padia nuk u materializua kurrë. Më vonë po atë vit, investigimi u vazhdua nga portali gjerman Netzpolitik, i cili tha se Acromax ka “efekt ftohës në lirinë e mediave në Shqipëri.” Çështja e dytë i referohet padisë SLAPP në dhjetor 2020 në Shqipëri kundër gazetarit investigativ Artan Rama, i cili publikoi në 6 nëntor 2020 një artikull investigativ “Prapaskenat e një kontrate të Dytë për Inceneratorin e Elbasanit”. Pas këtij artikulli, Albteq Energy, e cila fitoi koncesionin për ndërtimin e inceneratorit të mbetjeve në Elbasan gjashtë vjet më parë, paditi gazetarin investigativ për shpifje. Artan Rama tha se i qëndronte artikullit të botuar dhe se do ta mbronte atë në gjykatë. Çështja e tretë është një tjetër padi gjyqësore. Shefja e Kabinetit të Ministrisë së Mbrojtjes kishte paditur gazetaren Juli Ristani, e cila kishte botuar në gazetën ‘Shqip’ një artikull investigativ për akordimin e bursave për studime mjekësore ushtarake në Greqi, të ofruara nga NATO.

Kërcënime kundër jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve

Në 24 mars 2020, Gazetari i Ora News Elio Laze publikoi një video ku kërcënohej nga një punonjës i Firmës së Ndërtimit Salillari. Gazetari ndodhej në kantier në rrugën e Unazës në Tiranë dhe po filmonte kompaninë që po vazhdonte punimet, edhe pse aktivitete të tilla ishin të ndaluara për shkak të kufizimeve të Covid-19. Si rezultat i kësaj shkeljeje, gazetari filmoi punëtorët teksa punonin dhe iu afrua njërit prej tyre për komente. Punonjësi i Salillarit, një prej kompanive të preferuara të ndërtimit të qeverisë, u përgjigj duke u treguar agresiv verbalisht dhe fizikisht me gazetarin dhe duke e kërcënuar atë.

Pas shembjes së Teatrit Kombëtar në 17 maj 2020, redaktori i [Politiko.al](#) Alfred Lela u arrestua me dhunë teksa raportonte për protestën. Policia pretendoi se ai “nuk ishte në detyrë” në atë kohë. Ai u la i lirë pa iu ngritur ndonjë akuzë, por pretendoi se ishte sulmuar dhe ofenduar verbalisht nga policia. Karikaturisti Diversanti i Exit New ishte në teatër gjatë kohës që po shkatërrohej ndërtesa dhe u tërhoq me forcë e u arrestua nga forcat speciale të cilët mësynë ndërtesën. Ai u la i lirë pa iu ngritur ndonjë akuzë, por raportoi përdorimin e dhunës dhe forcës së tepruar nga policët që mbanin armë gjysmë-automatike. Në 17 qershor Hila po filmonte prishjen e një ndërtese nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) në një plazh në Lezhë duke përdorur celularin e tij. Pasi Hila u tha se ishte gazetar, oficeri i policisë i mori telefonin nga duart, duke bërë titull “Çfarë gazetari je!?”. Ai u ndalua edhe pse e identifikoi veten si gazetar disa herë dhe oficerët e policisë në zonë kishin informuar shefin e policisë për profesionin e tij. Ai u ndalua në automjetin e policisë pranë vendit të rrënojave të prishjes së ndërtesës dhe më pas u la i lirë për shkak të presionit nga gazetarët e tjerë. Në 30 tetor 2020, pak pas mesnatës, një shpërthim tronditi shtëpinë e Eldion Ndrekes, reporterit dhe gazetarit lokal të News24. Në momentin e shpërthimit, Ndreka ishte në shtëpi me familjen e tij. Shpërthimi shkaktoi vetëm dëme materiale. Pamjet e kamerave të sigurisë tregojnë një person duke dalë nga një makinë, duke lënë eksplozivin dhe duke u larguar me shpejtësi nga vendi. Policia dhe njësi hetimore ishin në skenë në qytetin e Lezhës dhe vazhdojnë me hetimet për rrethanat e ngjarjes, për identifikimin dhe kapjen e autorit të kësaj veprë. Asnjë arrestim nuk është bërë deri më tani për këtë ngjarje. Më 11 dhjetor, policia ndaloi Xhoi Malësinë, gazetar dhe spiker i lajmeve në RTV Ora News, teksa filmonte protestat. Gazetari u lirua pas tre orësh, por raportoi abuzime me të drejtat e tij: “Më ndaloi policia teksa po filmoja protestën, edhe pse u identifikova si gazetar. Më morën në rajonin e policisë, ku oficerët e policisë më keqtrajtuan dhe më fyen,” tha Malësia për Rrjetin e Gazetarëve të Sigurt. Ai shtoi se nuk e kishin lejuar të ushtronte të drejtën e një telefonate. “Më liruan tre orë më vonë pasi më detyruan të firmosja një deklaratë që nuk e kisha shkruar, por që m’u imponua nga oficerët e policisë si kusht për të më lënë të lirë.” Më 11 dhjetor, Qamil Xhani, kryeredaktor i gazetës së përditshme ‘Koha Jonë’, u arrestua teksa ishte në krye të detyrës. Pasi kishte mbaruar raportimin, Xhani u bë dëshmitar i dhunës së policisë ndaj protestuesve. Ai u kërkoi punonjësve të policisë të ndalonin, por u prangos dhe u ndalua bashkë me 50 protestues të tjerë. Xhani deklaroi se ishte goditur në kokë dhe në shpinë. Policia i sekuestroi celularin dhe i fshiu të gjitha pamjet dhe filmimet. Edhe atij iu bë presion për të nënshkruar një deklaratë duke

pranuar se ishte ndaluar për “pjesëmarrje në një tubim të paligjshëm”. Xhani u la i lirë vetëm kur botuesi i “Koha Jonë” kontaktoi drejtpërdrejt me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë dhe çështja u raportua live në mbrëmjen e programit televiziv. Redaktori i Durrës Lajm Shefqet Duka u ndalua nga policia teksa po largohej nga ambientet e medias pranë Sheshit Liria ku po zhvilloheshin protestat. Ai u dërgua në rajonin e policisë dhe ishte mbajtur për më shumë se tre orë. Staf i Durrës Lajm kontaktoi zëdhënësin e policisë lokale për të shprehur shqetësimet e tyre. Pas lirimit, Duka konfirmoi se oficerët e policisë nuk kishin përdorur dhunë ndaj tij, por kishte qenë dëshmitar i dhunës ndaj protestuesve të tjerë. Aldo Mustafa, gazetari lokal i [Syri.net](#) TV në qytetin e Durrësit ishte në detyrë duke raportuar drejtpërdrejt protestën në vendlindjen e tij kur u sulmua nga një prej policëve dhe nuk u lejua të filmonte dhe raportonte për ndalimin e protestuesve nga Policia.

Numri dhe llojet e vrasjeve

Në 7 janar 2020, Kastriot Reçi, pronar i “Media Plus TV” u vra në Rrëshen të Mirditës. Në të njëjtën ditë, policia dha një deklaratë ku thuhej se “sot në 11:05, në Rrëshen të Mirditës, u vra me armë zjarri në rrethana të paqarta KR. Vrasësi nuk është identifikuar ende nga policia. Është ngritur grupi hetimor për identifikimin e autorëve të kësaj vrasjeje. Ai dyshohet se ishte i lidhur me trafikun e drogës.

Numri dhe llojet e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj institucioneve, organizatave të medias dhe shoqatave të mediave dhe gazetarëve

Në janar, Acromax kërcënoi të padiste Alice Taylor dhe [Exit.al](#) për një hetim që kjo e fundit kishte bërë për punën e kompanisë. Taylor kishte publikuar një artikull ku përfshinte detaje të një bisede që kishte zhvilluar me pronarin e Acromax, Aldor Nini. Në atë bisedë, Nini pranoi se Partia Socialiste ishte klient i kompanisë së tij dhe madje dërgoi shembuj të punës që kishte bërë për ta. Kjo përfshinte heqjen e përmbajtjes nga platformat e mediave sociale, të tilla si Facebook dhe YouTube. Nini më vonë pretendoi se PS nuk ishte më klienti i kompanisë së tij dhe kërcënoi me padi gjyqësore në Gjermani dhe Shqipëri kundër Taylor dhe portalit [Exit.al](#). Padi nuk u materializua asnjëherë. Faqja e internetit e Citizen Channel u sulmua disa herë dhe më pas u bllokua plotësisht për shkak të sulmeve të cPanel.

C2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe aktorëve politikë në lidhje me mbrojtjen e gazetarëve

A ka dispozita të veçanta në ligje ose mekanizma të tjerë që synojnë të mbështesin sigurinë e gazetarëve, në terren dhe online?

Liria e shprehjes është e garantuar, por nuk ka ligje të veçanta për sigurinë e gazetarëve. Gjithsesi, në bazë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, shtetet anëtare (përfshirë Shqipërinë) kanë detyrime negative dhe pozitive për të mbrojtur gazetarët. Jo vetëm që ata duhet të mos bëjnë deklaratë kërcënuese politike apo të nisin procese gjyqësore kundër aktorëve të medias, por kanë për detyrë edhe t’u japin gazetarëve vazhdimisht mbrojtjen e plotë ligjore dhe gjyqësore në mënyrë që t’u krijojnë një mjedis të përshtatshëm për punën e tyre në gazetari.¹⁰³ Institucioneve shtetërore u mungojnë burimet dhe kapacitetet për të mbrojtur gazetarët në hapësirën online dhe në terren.

A ka dokumente (protokolle, rregulla të procedurave, etj.) të miratuara nga institucionet shtetërore që u japin udhëzime shtesë forcave të armatosura dhe policisë për mënyrën se si të sillen me gazetarët?

Disa institucione shtetërore janë trajnuar se si të ndërveprojnë me gazetarët dhe profesionistët e medias, por ka protokolle zyrtare të kufizuara që janë miratuar. Institucionet e drejtësisë normalisht duhet të kenë rregulla për marrëdhëniet/komunikimin me publikun, por jo gjithnjë ndodh kështu. Gjithsesi, në vitin 2019, Prokuroria e Përgjithshme lëshoi një Udhëzim për Marrëdhëniet me Publikun për prokuroritë e rretheve gjyqësore, ku rregullon disi rolin e policisë gjyqësore në ndarjen/ose refuzimin për të dhënë informacione që sigurojnë gjatë një hetimi. Në përgjithësi, marrëdhëniet e institucioneve të drejtësisë me mediat rregullohen me dispozita të përgjithshme në ligjin organik të secilit institucion të drejtësisë. Kohët e fundit, ofrohet në gjuhën shqipe një kurs i ri online për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gazetarëve për profesionistët e sistemit ligjor, por edhe për gazetarët dhe zyrtarët e organeve të zbatimit të ligjit për identifikimin dhe trajtimin e

¹⁰³ Këshilli i Evropës “Kurse online për mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve ofrohen në disa gjuhë të Ballkanit Perëndimor”, gjendet në adresën <https://www.coe.int/fr/web/pristina/-/online-course-on-protection-and-safety-of-journalists-available-in-western-balkans-languages>

kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias.¹⁰⁴

A ka ndonjë mekanizëm për monitorimin dhe raportimin e kërcënimeve, ngacmimeve dhe dhunës ndaj gazetarëve? A publikojnë institucionet shtetërore të dhëna për sulmet ndaj gazetarëve dhe për pandëshkueshmërinë?

Institucionet në Shqipëri nuk publikojnë të dhëna në lidhje me sulmet ndaj gazetarëve dhe pandëshkueshmërinë e tyre. Institucionet shtetërore nuk mbajnë të dhëna të hollësishme për sulmet ndaj gazetarëve dhe as nuk publikojnë të dhëna në lidhje me to. Institucioneve shtetërore u mungojnë burimet dhe kapacitetet për të mbledhur dhe publikuar të dhëna të tilla. Këshilli i Evropës, Përgjigja e Shpejtë për Lirinë e Mediave dhe Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt janë mekanizmat kryesorë për monitorimin dhe raportimin e rregullat për kërcënime të tilla.

A njihen sulmet ndaj sigurisë së gazetarëve nga institucionet shtetërore si shkelje e lirisë së shprehjes dhe e Kodit Penal? A japin zyrtarët qeveritarë deklarata të qarta ku dënojnë sulmet ndaj gazetarëve?

Sulmet ndaj sigurisë së gazetarëve zakonisht dënohen nga zyrtarët shtetërorë dhe konsiderohen si shkelje e lirisë së shprehjes.

A bashkëpunojnë institucionet shtetërore me organizatat e gazetarëve për çështjet e sigurisë së gazetarëve?

Institucionet e pavarura, të tillë si Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Komisioneri i të Drejtës së Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave, bashkëpunojnë me organizatat e gazetarëve për sigurinë e këtyre të fundit.

Në rastet e mbikëqyrjes elektronike, a e respektojnë institucionet shtetërore lirinë e shprehjes dhe privatësinë? Cili ishte rasti më i fundit i mbikëqyrjes elektronike ndaj gazetarët?

Nuk ka raste zyrtare apo publike për mbikëqyrjen e gazetarëve.

C3 Sjellja e sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve

A ka njësi të veçanta brenda institucioneve të sistemit të drejtësisë civile kushtuar hetimeve dhe ndjekjeve penale të kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve?

Nuk ka njësi të veçanta brenda institucioneve të sistemit të drejtësisë civile që të merret me hetimet dhe ndjekjen penale të kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve.

A ofrojnë Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Brendshme burimet e nevojshme për të bërë hetimet për kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve?

Nuk ka asnjë dispozitë të veçantë për burime të tjera që do të mbulonin dhe trajtonin hetimet për kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve.

A bëhen me shpejtësi, paanshmëri dhe efikasitet hetime për krimet ndaj gazetarëve, përfshirë këtu kërcënimet dhe frikësimet ndaj tyre?

Raporte dhe të dhëna të ndryshme nga gazetarët evidentojnë faktin se bëhen një numër i kufizuar hetimesh të paanshme dhe efikase për krimet ndaj gazetarëve.

A u ofrohen gazetarëve masa të mbrojtjes kur e kërkojnë ata në përgjigje të kërcënimeve të besueshme për sigurinë e tyre fizike?

Institucionet shtetërore nuk ofrojnë ndonjë mbrojtje të veçantë, por organizatat e mediave, rrjetet ndërkombëtare të mediave dhe shoqëria civile ofrojnë mbështetje dhe burime.

¹⁰⁴ Ky kurs u krijua nga Këshilli i Evropës (Drejtorja e Shqëritë së Informacionit), në bashkëpunim me HELP Programi HELP (Edukimi mbi të drejtat e njeriut për juristët) në kuadër të Aksionit "Freedom Liria e shprehjes dhe Liria e Mediave në Evropën Juglindore (JUFREX 2)" që po zbatohet nga Programi i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Lehtësia Horizontale për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë II (2019-2022)".

Në rast të vendimit të formës së prerë, ndëshkohen vetëm shkelësit apo edhe nxitësit/porositësit?

Nuk ka informacione për këtë çështje.

A organizojnë institucionet trajnime të përshtatshme për policinë, prokurorët, avokatët dhe gjyqtarët në lidhje me mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe të gazetarëve? A i organizojnë institucionet këto trajnime në bashkëpunim me shoqatat e gazetarëve?

Me mbështetje të donatorëve të huaj, janë organizuar trajnime, por ka nevojë për ngritje kapacitetesh si dhe rritje të ndërgjegjësimit.

Përfundimet

Kushtetuta e Shqipërisë garanton lirinë e shprehjes, të medias dhe të informimit, por kjo liri nuk zbatohet plotësisht në praktikë ku evidentohen shenja të përkeqësimit të lirisë së shprehjes, të informimit dhe të shtypit. Qeveria shqiptare ka tentuar të prezantojë ndryshime ligjore që konsiderohen si shkelje të lirisë së shprehjes dhe të medias. Puna e Autoritetit të Mediave Audiovizive si autoritet rregullator karakterizohet nga debatet politike në lidhje me pavarësinë dhe praktikën e punës. Tregu i reklamave ka ndikim tejet të madh në nivelin e integritetit të mediave në Shqipëri për shkak të disa faktorëve, siç janë efikasiteti i zbatimit të mekanizmave ligjorë, tregu i vogël për nga madhësia dhe varësia e mediave nga aktorët ekonomikë dhe politikë.

Nuk jepen asnjë lloj subvencionesh apo fondesh për mediat për prodhimin e përmbajtjeve me interes publik. Në vitet e fundit, nuk është hartuar apo zbatuar asnjë politikë shtetërore në lidhje me pakicat dhe mediat. Radio Televizioni Shqiptar (RTSH) është transmetuesi i vetëm publik në shërbim të publikut në Shqipëri dhe autonomia dhe pavarësia e tij garantohen me ligj. Në Shqipëri, dhe në kundërshtim me praktikën më të mira ndërkombëtare, shpifja konsiderohet kundërvajtje penale. Në vitin 2020 janë regjistruar me dhjetëra procese gjyqësore kundër gazetarëve, kryesisht për shpifje. Në disa raste është kërcënuar pavarësia e punës së gazetarëve përmes rritjes së numrit të proceseve gjyqësore kundër tyre, veçanërisht kundër gazetarëve investigativë. Në vitin 2020 Aleanca Shqiptare për Media Etike krijoi mekanizma vetërregullimi. Pluralizmi politik në media nuk rregullohet nga ligji për mediat përtej procesit zgjedhor përveç Transmetuesit të Shërbimit Publik. Në përgjithësi, liria e punës dhe e organizimit në shoqata për gazetarët është e garantuar. Nga ana tjetër, transparenca e kufizuar, qoftë e qëllimshme apo për shkak të detyrës, e institucioneve shtetërore pengon punën e gazetarëve.

Për sa i përket pozicionit ekonomik të gazetarëve, vështirësitë kryesore vazhduan edhe në vitin 2020, veçanërisht në lidhje me punësimin, kushtet e punës, sigurinë dhe zhvillimin profesional. Pavarësia editoriale ndikohet nga lidhjet e ngushta mes mediave, politikës dhe bizneseve. Disa media jofitimprurëse kanë arritur të ruajnë pavarësinë editoriale. Vetëcensurimi është akoma i pranishëm. Kushtet e punës së gazetareve femra janë në pjesën më të madhe të rasteve më të vështira se ato të gazetarëve meshkuj, veçanërisht për sa i përket pagave, kërcënimeve, pozicioneve drejtuese në redaksi dhe ngacmimeve. Gazetarët që punojnë për portalet e mediave online dhe në mediat lokale jashtë Tiranës përballen me më shumë vështirësi sesa homologët e tyre në mediat kryesore dhe me qendër në Tiranë. Gazetarët në terren raportojnë se ndihen të pambrojtur nga kërcënimet fizike. Gazetarët investigativë raportojnë se kanë frikë nga proceset gjyqësore që ndërmerren nga aktorë që preken nga puna e tyre. Gazetarët e rinj përballen me sfida të tjera, përfshirë këtu edhe mungesën e solidaritetit nga kolegët e tyre me përvojë. Në një studim të vitit 2020 të Komitetit Shqiptar të Helsinkit konfirmohet se mungesa e sindikatave të gazetarëve brenda organeve të mediave dhe indiferenca e institucioneve publike ndaj propozimeve të shoqatave të gazetarëve rreth të drejtave të punës kanë bërë që gazetaret të jenë të pambrojtur përballë abuzimit me të drejtat e punës.

Shqetësimet për sigurinë e gazetarëve u rritën në vitin 2020 me 19 raste, përfshirë kërcënime kundër jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve, kërcënime dhe ngacmime jo-fizike, sulme faktike, vrasje të gazetarëve dhe kërcënime dhe sulme ndaj institucioneve të medias, organizatave, mediave dhe shoqatave të gazetarëve. Nuk ka dispozita të veçanta për sigurinë e gazetarëve, ndërkohë që institucionet shtetërore kanë kapacitete, burime dhe vullnet të pamjaftueshëm për të garantuar sigurinë e gazetarëve. Institucionet në Shqipëri nuk publikojnë të dhëna për sulmet ndaj gazetarëve dhe për pandëshkueshmërinë. Përgjithësisht, sulmet ndaj gazetarëve dënohen nga zyrtarët shtetërorë dhe konsiderohen si shkelje e lirisë së shprehjes. Gjithsesi, është e rëndësishme që agjencitë e zbatimit të ligjit t'i hetojnë deri në fund këto sulme.

Liria e medias në Shqipëri pësoi rënie gjatë vitit 2020, duke bërë që Shqipëria të renditet në vendin e 84-të në Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit për vitin 2020, duke rënë kështu me dy pozicione në krahasim me vitin 2019 (atëherë renditej e 82-ta).¹⁰⁵ Në Platformën e Këshillit të Evropës ku promovohet mbrojtja dhe siguria e gazetarëve, Shqipëria ka të regjistruara 15 raste aktive për lirinë e medias me vetëm pesë të zgjidhura, brenda pesë viteve (2015-2020).¹⁰⁶ Siç thonë edhe ekspertët, 'pandemia i dha një mundësi për propagandë Kryeministrit Edi Rama, i cili mori drejtimin e komunikimit duke qenë vazhdimisht i pranishëm në mediat sociale dhe me transmetuesin online ERTV. Raportohet se, vetëm në muajin e parë të mbylljes totale, Kryeministri publikoi 407 postime në Facebook (13 në ditë) dhe 47 orë video, duke krijuar kështu përvojën e parë të qeverisjes së Shqipërisë përmes mediave sociale'.¹⁰⁷ Kriza COVID-19 i përkeqësoi më shumë vështirësitë ekzistuese të mediave në Shqipëri, krahas lirisë së medias.¹⁰⁸ Sipas Freedom House 2020, ndonëse Kushtetuta garanton lirinë e shprehjes, ndërthurja e interesave të bizneseve të fuqishme, me ato politike dhe me mediat pengon zhvillimin e mediave të pavarura teksa shumica e mediave në vend shihen si të njëanshme. Gazetarët kanë pak siguri për punën dhe bëhen subjekt i proceseve gjyqësore, kërcënimeve dhe sulmeve të herëpashershme fizike nga ata që përballen me mbikëqyrjen e mediave. Shtypi vazhdon të ketë rënie të të ardhurave, gjë që ka detyruar uljen e pagave të gazetarëve.¹⁰⁹

105 Reporterë pa kufi, "Raporti për Shqipërinë 2020, Liria e Mediave", aksesuar më 15.03.2021, <https://rsf.org/en/albania>

106 Këshilli i Evropës, "Liria e Mediave", aksesuar më 24.11.2020: https://www.coe.int/en/web/media-freedom/all-alerts?p_p_id=sojdashboard_WAR_coesoportlet&p_p_lifecycle=0&p_p_col_id=column-4&p_p_col_count=1&sojdashboard_WAR_coesoportlet_keywords=&sojdashboard_WAR_coesoportlet_selectedStringFilters=resolution.activealerts.year.2015.year.2017.year.2019.year.2016.year.2018.year.2020&sojdashboard_WAR_coesoportlet_selectedCategories=11709474

107 Gentila Madhi, "Informimi publik në Shqipëri bëhet viktimë e COVID-19", Observatori Ballkanik, aksesuar më 15.03.2021: <https://www.balkanicaucaso.org/en/Areas/Albania/Albania-public-information-becomes-casualty-of-COVID-19-202724>

108 Blerjana Bino et al., "Roli i Shoqërisë Civile dhe Medias në Menaxhimin e Krizave në Shqipëri", Tiranë: Fondacioni Westminster për Demokraci, 2020), aksesuar më 15.03.2021: <https://www.wfd.org/2020/12/22/the-role-of-civil-society-and-media-in-crises-management-in-albania/>

109 Gjergji Vurmo, "Liria në Botë 2020: Shqipëria", aksesuar më 15.05.2021: <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2020>

Ndër rekomandimet kryesore për politikëbërësit për çdo fushë janë si më poshtë:

A. MBROJTJA LIGJORE

- Të sigurohet zbatimi i plotë i garancive ligjore për lirinë e shprehjes dhe të medias si dhe të ofrohet një mjedis mediatik mundësues në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Të rishikohet legjislacioni për mediat për ta sjellë atë plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare për lirinë e shprehjes, veçanërisht në lidhje me mediat online;
- Të sigurohet transparenca e reklamave publike dhe shtetërore;
- Të përmirësohet transparenca për pronësinë e mediave;
- Të krijohen dhe përmirësohen mekanizmat vetërrregullues me kapacitete ekzekutive;
- Të krijohet një sindikatë në Transmetuesin e Shërbimit Publik.

B. POZICIONI I GAZETARËVE NË REDAKSITË E LAJMEVE

- Të rritet transparenca dhe llogaridhënia e autoritetit rregullator të mediave;
- Të forcohet pavarësia e transmetuesit publik në shërbim të publikut;
- Të forcohet zbatimi i vendimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit/Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Të përmirësohet barazia gjinore në redaksi;
- Të mbrohen anëtarët e komunitetit LGBTQ dhe të pakicave të tjera.

C. SIGURIA E GAZETARËVE

- Të zbatohet një politikë e tolerancës zero për kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve, si dhe për kërcënimet ndaj medias, përfshirë këtu edhe në debatin politik;
- Të ofrohet mbrojtje dhe hapësirë e sigurt për gazetarët;
- Të zbatohet Kodi i Punës dhe të forcohet mbrojtja e të drejtave të punës dhe sigurimeve shoqërore për gazetarët në Shqipëri;
- Të mblidhen dhe botohen të dhëna të rregullta për sigurinë e gazetarëve, për kushtet e punës dhe çështje të tjera të lidhura me to;
- T'u jepen pajisje mbrojtëse njerëzve që punojnë në media, të cilët do të vazhdojnë të raportojnë nga terreni;
- Të bashkëpunohet me institucionet shtetërore (policinë, prokurorinë, etj.) dhe organizata ndërkombëtare (Prezenca e OSBE-së, për shembull) që merren me çështje të sigurisë;
- Të bashkëpunohet (për ngritjen e kapaciteteve, për grante dhe aktivitete advokimi) me sindikatat më të rëndësishme për promovimin e të drejtave të njeriut dhe të gazetarëve dhe për nisjen e dialogut dhe politikave të reja për të drejtat e punës për gazetarët.

D. PËR SHOQATAT E GAZETARËVE

- Të krijohet një platformë të përbashkët e shoqatave të gazetarëve, mediave dhe atyre që ofrojnë mbështetje ligjore dhe profesionale në bashkëpunim me nismat ekzistuese për gazetarët dhe redaktorët, siguria e të cilëve është nën kërcënim;
- Të mbështetet gazetaria fakt-verifikuese dhe ajo investigative, por jepen edhe mesazhe të thelluara përmes të cilave qytetarët të kuptojnë proceset dhe marrëdhëniet dhe jo thjesht vetëm faktet e paraqitura;
- Të mbështeten gazetaret gra, gazetarët e rinj dhe gazetarët që punojnë në mediat lokale;
- Të ofrohet ngritja e kapaciteteve, të mobilizohen burimet dhe të mblidhen fonde për shoqatat e gazetarëve;
- Të forcohen mekanizmat e vetë-rregullimit;
- Të krijohen dhe konsolidohen mekanizmat e vetë-rregullimit me kapacitete ekzekutive;
- Të rritet ndërgjegjësimi, mbështetja dhe fuqizimi i gazetarëve që ende nuk kanë vullnetin të raportojnë shkeljet e të drejtave të tyre të punës nga frika e humbjes së vendit të punës dhe për shkak të mungesës së besimit të sistemi i drejtësisë;
- Të rritet solidaritetit mes shoqatave të gazetarëve për secilin rast të censurës ose sulmit ndaj anëtarëve dhe/ose përfaqësuesve të mediave për shkak të profesionit.

